

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7751 E enjte 27 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Newsweek"

A duhet të konsiderojmë nisjen e procedurave për shkarkimin (impeachment) e presidentit Donald Trump? Shumëkush dridhet nga kjo ide, duke u frikësuar ...
Vijon në faqen 20

Nga ELIZABETH HOLTZMAN

Procedura e shkarkimit të Donald Trump mund të fillojë që tani



Opinion Ditës

Parlamenti në Prishtinë miratoi në vitin 2015 një ligj që lejon funksionimin e Dhomave të Specializuara, por shenjat se aktakuzat e para të gjykatës së re ...
Vijon në faqen 21

Nga DIE MORINA

Kosovë: Thirren në Hagë komandantët e parë guerillas



Tragedji në Laprakë/ Mister motivet **Atentat në makinë, vdes me plumb në kokë 17-vjeçarja, plagoset i riu**

Autori me kapuç të zi në kokë qëllon të rinjtë. Dyshimi, ishin në një lidhje dashurie

Të gjithë emigrantët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit do kenë mundësi që të shprehin vullnetin e tyre për forcat politike dhe kandidatët që duhet të drejtojnë vendin dhe qytetin e tyre. Partia Socialiste ka zyrtarizuar në Kuvend ndryshimet në Kodin Zgjedhor, ku ndërmjet të tjerave plotëson edhe një kërkesë të hershme ...

Në faqen 9

VENDIMET/ ARSIM FALAS PER EKSELENTET. BURSE 10 MIJE LEKE NE MUJ PER 4 KATEGORI

QEVERIA PERGJYSMON TARIFAT PER STUDENTET

Rama: Brenda vitit 2019 do shpërndahet karta e studentit, ligji i arsimit nuk preket. "Lëvizja për Universitetin": Nuk u dha zgjidhje për kërkesat tona



(Në foto) Studentë duke protestuar përpara Ministrisë së Arsimit

Në faqen 3

NE PRAG TE FUSHATES
Zbardhet axhenda e Asamblesë së PS, Edi Rama përgatit ndryshime në qeveri
Në faqen 5

STUDIUESJA
Si u mbyll pas 20 vitesh "Onufri", Eleni Laperi: E vendosi ministria
Në faqet 16-17

STATISTIKAT
330 mijë shqiptarë morën nënshtetësi në vendet e BE-së që nga viti 2002
Në faqen 14

SANKSIONET
Projektligji, gjoba deri në 300 mijë lekë për plagjiatura
Në faqen 11

NDERKOMBETARET



Ligji i ri kundër portaleve, 4 shoqata të huaja Ramës: Jemi të zhgënjyer, tërhiq
Në faqen 8

Përplasja/ Opozita: U ndryshua plani urbanistik që të ndërtojë Edmond Bego

PD: Pse u devijua Lana. Bashkia: S'ka leje ndërtimi

Banorët e "Astirit" vazhdojnë protestat: Kërkojmë dëmshpërblim 100%

Nga VALENTINA MADANI

Protesta e banorëve të zonës së "Astirit" hyri dje në ditën e 53-të. Ata kërkojnë dëmshpërblim 100% dhe anulimin e plotë të projektit të Unazës së Madhe. Banorët bllokuan rrugën, ndërkohë që paralelisht me protestën, një



makinë është përfshirë nga flakët në vendin ku banorët kanë bllokuar rrugën. Mësohet se nga zjarri që ka rënë në makinë nuk kishte të lënduar. Ata kërkuar sërish dje anulimin e projektit për ndërtimin e Unazës së Madhe. Banorët e kanë qajtur këtë ...

Në faqen 6

STUDENTËT PROTESTA

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, e kundërshtoi dje pa vonesë paktin e qeverisë për universitetin ku adresoheshin të gjitha pikat që kanë kërkuar studentët. Për Bashën, buxheti është tregues kryesor që paketa nuk jep zgjidhje. Basha i quajti cikërrima, mashtrime dhe riciklim të premtimeve të kryeministrit Rama nga frika e protestave studentore. "Cikërrimat dhe mashtrimet me të cilat doli sot janë riciklim i atyre që ka thënë gjatë këtyre ditëve nuk zgjidhin asnjë nga problemet e thella me të cilat përballen studentët. Tha që do i bëjë konviktet brenda mandatit, por konviktet nuk janë Unaza", - tha ai. Sipas Bashës, dy janë zgjidhjet për daljen nga kjo situatë. Propozimi i Bashës që të dalin nga kjo situatë janë dy pika, e para anulimi i ligjit të arsimit të lartë. Së dyti, ai propozon dyfishimin e buxhetit të arsimit të lartë, që do të mundësojë uljen e shpenzimeve për familjet dhe investimet në infrastrukturë. "E para, anulimi i ligjit korruptiv për arsimin e lartë, që është zanafilla e së keqes. Kemi sot arsimin e lartë më të shtrenjtë në Europë dhe me cilësinë më të dobët në Europë. Sh-tylla e dytë është dyfishimi i buxhetit për arsimin e lartë. Edi Rama foli 45 minuta dhe tha lloj-lloj gjërash, por nuk thotë se buxheti i arsimit të lartë është rritur me 2 milionë dollarë. Propozimi ynë është i qartë dhe i thjeshtë, dyfishim i buxhetit për arsimin e lartë. Do të thotë 74 milionë dollarë më shumë që do shpenzohen në dy drejtime. Së pari, për të subvencionuar tarifën e studentëve, ndërsa pjesa tjetër e parave do të investohen në infrastrukturë konviktores", deklaroi z.Basha. Sipas Bashës, tarifa totale e këtij propozimi të Partisë Demokratike që të mbulohej që të gjitha familjet nën 640 mijë lekë të vjetra të ardhura në muaj duke mos paguar asnjë tarifë, si dhe ato me të ardhura mbi 640 mijë lekë të vjetra në muaj të paguajnë vetëm gjysmën e tarifës, është 38 milionë dollarë. "Subvencionim i tarifave të studentëve dhe për të mbështetur përmes subvencionit social, ata studentë, prindërit e të cilëve nuk kanë asnjë mundësi ekonomike që të paguajnë as shumën më të vogël për jetesën e tyre, qoftë kjo qira, ushqim, veshmbathje, libra, transport, telefon apo shpen-

VKM-të, kreu i PD: Alternativa, dy mënyra për të plotësuar kërkesat e studentëve

Zgjidhja, Basha: Si do i investojmë 74 milionë dollarë në arsim

"Pakti për universitetin, cikërrimat s'japin zgjidhje"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

LUÇIANO BOÇI

"Mashtrimi vazhdon. S'ka asnjë vendim konkret që të bindë studentët që buxheti dedikuar arsimit do arrijë nivelin e 5%. Kjo rritje konsiderohet nga studentët si çelësi themelor për kërkesat e tjera. Madje, vendimet si dhe rrëzimi në seancë i propozimeve amenduese, faktikisht qëndrimin negativist të Ramës për këtë pikë. Studentët kërkojnë që kjo mbështetje të sanksionohet me ligj", tha z.Boçi.

"Tenton të asgjësojë rolin jetik të opozitës"

Mazhoranca rrëzoi dekretin e Metës, PD-LSI bëjnë kallëzim penal në prokurori

PD dhe LSI depozituan dje kallëzim penal lidhur me rrëzimin e dekretit të Presidentit Meta, i cili kthehet në Kuvendin ligjin "për tatimin mbi të ardhurat". Sipas kallëzimit penal që mban datën 26 dhjetor, rrëzimi i dekretit është bërë pa kaluar 12 orë nga administrimi në Kuvend dhe opozita e cilëson një akt të paprecedentë. "Nuk ka ndodhur asnjëherë që dekreti i kreu të shtetit as të mos studiohet përsa i takon arsyes së kthimit të tij. Ky akt i mazhorancës është një veprim i pashembullt paligjshmërie dhe arrogancë, që tregon degradimin e Kuvendit deri në atë nivel sa pamundëson bashkëjetesën parlamentare, e cila

DEKRETI
Më 20 dhjetor deputetët socialistë vendosën ta rrëzojnë atë me 76 vota. Që nga 1 janari, bizneset e mëdha do të paguajnë më pak taksa për shpërndarjen e fitimeve.

në vetvete është vepra më e rëndë penale që mund të konsumojë deputet gjatë ushtrimit të mandatit të përfaqësimit që i ka dhënë populli. Dekreti i Presidentit të Republikës i datës 20 dhjetor nuk mund të miratohej në seancë plenare të po të njëjtës ditë, për shkak se rregullorja e Kuvendit e ndalon këtë. Duke përfshirë për diskutim dhe miratim dekretin e presidentit nr. 11015, datë 20 dhjetor 2018 në seancë

plenare të datës 20 dhjetor mazhoranca parlamentare u ka mohuar të drejtën kushtetuese deputetëve të opozitës që të njihen me dekretin e presidentit dhe përmbajtjen e arsytimit që e shogëron atë", shkruhet në kallëzimin penal. Opozita shprehet se me këtë veprim janë konsumuar "Elemente të shpërdorimit të detyrës dhe ndikim të paligjshëm ndaj personave që ushtrjnë funksione publike". Kallëzimi penal prej 7 fashesh që i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, asaj të Krimeve të Rënda dhe Prokurorisë së Tiranës mban firmën e Edmond Spahos dhe Vasilit, dy krerët e grupeve parlamentare, PD e LSI.


zime të tjera të jetës së përditshme. Nuk dua të ndalem

gjatë sesa i kushton një student një familjeje shqiptare.

Kemi mundësinë t'i rikthehem kësaj çështje, e diskutu-

ALTERNATIVA

"Propozimi ynë është i qartë dhe i thjeshtë: dyfishim i buxhetit për arsimin e lartë. Aktualisht kjo do të thotë një vlerë prej afërsisht 74 milionë dollarë më shumë se sa ato që janë planifikuar. Për shumicën dërrmuese të studentëve nuk ka zgjidhje tjetër përveçse subvencionimit të plotë të tarifës", tha z.Basha.



Mbledhja e Këshillit të Ministrave

Studentët, Shehu: Rama ua realizon kërkesat si Plaku i Vitit të Ri

Deputeti i PD-së, Tritan Shehu, deklaroi dje se kryeministri Rama është shpallur "non grata" nga universitetet dhe në panik të plotë publikoi sot një kartë virtuale 3D. Ai shprehet se Rama zgjodhi të plotësojë kërkesat e studentëve si Plaku i Vitit të Ri, pa bërë asnjë ndryshim në buxhetin për arsimin. "Kryeministri, i shpallur 'persona non grata' nga universitetet, në panik 'publikon' një kartë virtuale në 3D për 8 kërkesat e universiteteve, kur ata janë me pushime. Dhe premtim të realizojë kërkesat si Plaku i Vitit të Ri, me dhuratë, pa bërë asnjë ndryshim në buxhetin për arsimin! Buxheti ynë për arsimin, në nivelin e 2,2% të GDP është nga më të ulëtit në botë. Premtimi i vjetër i Rilindjes e kërkesa e universiteteve janë që ai të arrijë në rreth 5% të GDP... ndërsa kryeministri thotë që ai mund të realizojë të gjitha kërkesat... edhe më shumë, por vetëm pa para! Gjetje e cuditshme kjo, por besoj se do jetë vetëm në 3D! Ndryshe nuk do na duhej buxheti, as shifra e premtuar 5%, gjë për të cilën ai duhet të na shpjegojë pse e ka bërë... kur nuk u dashka! Në fakt, ai dhe sot nuk ndryshon asgjë substanciale, shkatërrarë të degradimit, as buxhetin, as Ligjin e Arsimit të Lartë... vetëm premtim në 3D. Kur arsimi, shëndetësia etj., mund të rregulloheshin kaq lehtë 'falas' me 'shkopin e tij magjik' përse u prit kaq gjatë, pse studentët, pedagogët etj., u çuan deri në këtë gjendje?!", shprehet deputeti i PD-së.

va gjatë mbajtjes së qëndrimit tonë në parlament dhe amendamenteve, propozimeve që sollëm në parlament. Por dua t'ju them se për shumicën dërrmuese të studentëve nuk ka zgjidhje tjetër përveçse subvencionimit të plotë të tarifës. Pra, që prindërit dhe studentët

të mos paguajnë as tarifën e bachelor, as tarifën e masterit, nëse vijnë nga familje me të ardhura nën 640 mijë lekë të vjetra në muaj", deklaroi kreu i PD-së. Një tjetër zgjidhje sipas Bashës është largimi i qeverisë përpara përfundimit të mandatit të saj.

REDAKSION: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Dossier: Iv Kaloçi, Redaktor i Rrethëve: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli.

Art Designer: Nevila SAMARXHI. ADMINISTRATA: Përgjithësi e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtorja e Uzinës së Autokatorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel/Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redksksia@gazetashqiptare.com, SHTPYRUR në "Klasik" Shpk



Qeveria miratoi 9 vendime për t'i dhënë zgjidhje të gjitha kërkesave të studentëve

Tarifat e reja të studimit, sondazh nga studentët për pedagogët

Krijohet portali për transparencën e titujve shkencorë

Qeveria ka nisur të konkretizojë hapat e saj për plotësimin e kërkesave të studentëve. Në një mbledhje të kushtuar plotësisht çështjeve që dolën nga protesta e studentëve, qeveria ka miratuar 9 vendime që synojnë t'i japin zgjidhje të gjitha kërkesave të tyre. Në një dalje të posaçme për mediat, fill pas mbledhjes së qeverisë, kryeministri, Edi Rama ka bërë publike dhe zgjidhjet konkrete që ofron Pakti për Studentët që materializohet nëpërmjet këtyre 4 vendimeve dhe që sipas tij i jep zgjidhje të gjitha çështjeve, duke filluar nga tarifat dhe për të përfunduar me gjendjen e konvikteve dhe vetingun në universitete.



PËR GAZETARËT
"Paralelisht shumë shpejt ne do të nxjerrim dhe planin për rritjen e ndjeshme në çdo vit të kolegjeve profesionale dhe uljen e numrit të atyre që shkojnë në universitet për arsimin e lartë. Është një numër jashtë çdo lloj logjike dhe jashtë çdo lloj arsyeje. Ne nuk kemi nevojë për 300 gazetarë në vit, besoj për shembull. Ju kemi juve dhe na duket sikur jeni 3 mijë. Llogaritë 300 në vit, ku do shkojnë, ku do punësohen", tha Rama.

TARIFAT
Në lidhje me këtë kërkesë të studentëve kryeministri bëri të ditur se vendimi i miratuar parashikon se studentët nga familje në ndihme ekonomike, si edhe të verbrit dhe studentët paraplegjikë e tetraplegjikë, përfitojnë financimin 100% të tarifës së regjistrimit. Jo vetëm kaq, por studentët nga familje me ndihmë ekonomike, të verbër, paraplegjikë e tetraplegjikë përfitojnë, gjithashtu, bursë 10.000 lekë në muaj. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj vendimmarrjeje materializohet edhe premtimi që studentët me notë mesatare mbi 9, në çdo program studimi, përfitojnë financimin 100% të tarifës së regjistrimit, nga tarifë e plotë që paguanin përpara këtij vendimi, si dhe bursë 10.000 lekë në muaj. Ndërsa të gjithë studentët e tjerë përfitojnë financimin 50% të tarifës së regjistrimit. Por vendimi i qeverisë përcakton se studentët e humbasin këtë mundësi nëse nuk mbajnë gjatë studimit një mesatare mbi 6 në vitet pasardhëse. Sa i përket nivelit të dytë të studimeve qeveria merr përsipër që për studentët me notë mesatare mbi 9 në hyrje, studentët nga familje në ndihmë ekonomike, si edhe të verbrit dhe studentët paraplegjikë e tetraplegjikë, jetimë, fëmijët e policëve të vrarë, të përfitojnë financimin deri në 50% të tarifës së regjistrimit.

KONVIKTE
Kryeministri bëri të ditur se sa i përket kërkesës për përmirësimin e kushteve të jetesës në konvikte është e nevojshme që rishikohet në rritje mbështetja financiare që jep Buxheti i Shtetit, kjo pasi është në masë të ulët dhe i ref-

KARTA E STUDENTIT
MASR do të bëjë publike marrëveshjet e lidhura dhe listën e shërbimeve që përfitohen nga studentët me entet shtetërore, bashkitë dhe subjektet private. Ky proces duhet të përfundojë brenda dhjetorit 2019.

erohet çmimeve të përcaktuara me udhëzimin e vitit 2003. Ai bëri të ditur se në Aktin Normativ të buxhetit 2018 që pritet të miratohet së shpejti, janë parashikuar rreth 300 milionë lekë shtesë për kryerjen e investimeve në infrastrukturën e konvikteve për vitin 2019. Ndërsa nëpërmjet një financimi total prej 16.8 milionë euro dhënë nga qeveria gjermane, do të mundësohet rehabilitimi i një numri maksimal prej 13 godina të rezidencave studentore universitare në Tiranë (nga 37 godina që përllogariten të jenë në total në qytetin e Tiranës). Ndërkohë që Ministria e Financave dhe e Ekonomisë është duke negociuar me KFW për të vazhduar rehabilitimin e banesave studentore, për një projekt me vlerë 27 milionë euro nga të cilat 7 milionë euro grand dhe 20 milionë euro kredi.

TRANSPARENCA
Sa i përket kërkesës së për transparencën me buxhetin nga Ministria e Arsimit dhe IAL-ve dhe publikimi i të gjitha shpenzimeve online, kryeministri bëri të ditur se për këtë çështje është miratuar një VKM e posaçme. Për këtë krijohet portali i transparencës dhe të trajtimit të ankesave me qëllim garantimin e transparencës në institucio-

net publike të arsimit të lartë. Portali të jetë i aksesueshëm nga të gjithë dhe në të të publikohen online të dhëna të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të çdo institucioni të arsimit të lartë. Portali do të shërbejë edhe për publikimin e CV-ve të pedagogëve si dhe të titujve shkencor. Gjithashtu, nëpërmjet këtij vendimi krijohet struktura përgjegjëse për kontrollin e transparencës së arsimit të lartë për trajtimin e ankesave në platformën e transparencës online, kontrollin e transparencës.

TITUJ
Për këtë çështje Rama bëri të ditur se miratua VKM për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore. Ky vendim mundëson krijimin e arkivit digital të doktoraturave në Republikën e Shqipërisë, pranë Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin, Institutin e Arsimit të Lartë si dhe çdo institucion tjetër shtetëror që disponon kopje origjinale të disertacioneve kanë detyrimin që brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të depozitojnë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin kopje të njehsuar me origjinalin si dhe materialin në formë elektronike. Ministria përgjegjëse për arsimin

kryen kontrollin digjital antiplagjiaturë nëpërmjet një softueri për kontroll automatik si dhe programe apo pajisje të tjera. Ministria përgjegjëse për arsimin i përcjell institucionet të arsimit të lartë rezultatet e gjetjeve nga kontrolli antiplagjiaturë, mbi bazën e të cilave do të bëhet rivlerësimi mbi gradën shkencore të dyshuar si plagjiaturë. Institucioni i arsimit të lartë, brenda 90 ditëve nga vënia në dispozicion të gjetjeve të kontrollit antiplagjiaturë i njofton ministrinë përgjegjëse për arsimin vendimin e rivlerësimit përfundimtar për çdo gradë shkencore të shqyrtuar. Për performancën

Kryeministri bëri të ditur se ka firmosur urdhrin për ngritjen e Grupit të Punës për ndryshimin e VKM-së për Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, në mënyrë që të adresojnë në këtë Kod shumë nga shqetësimet e ngritura nga studentët. Gjithashtu, për këtë çështje të mbledhjen e qeverisë u miratua edhe vendimi për vlerësimin e performancës në mësimdhënie të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë, nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve.

BORDE
Qeveria miratoi vendimin "Për përcaktimin e kriteve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordit të administrimit. Qeveria bën shkakimin e anëtarëve të bordeve të emëruar nga Ministria e Arsimit. Emërimet e reja bëhen më një proces të hapur dhe vëmendje publike.

Vendimi, si do bëhet punësim për 1 mijë studentë ekselentë

Kryeministri Edi Rama bëri të ditur se qeveria nuk plotësuar vetëm 8 kërkesat e paraqitura nga studentët, por me vendimet e veta kishte bërë të mundur një sërë lehtësirash të tjera apo anagzhimesh që do të ndihmojnë në rritjen e performancës së arsimit të lartë. Një prej këtyre vendimeve mundëson edhe punësimin e 1 mijë studentëve ekselentë në administratën publike. Sipas këtij vendimi për vitin 2019, pozicionet vakante specialist dhe të barasvlefshëm në institucionet e administratës shtetërore jashtë shërbimit civil do të plotësohen me prioritet nga studentët e ekselencës të diplomuar duke filluar nga viti 2017 e në vijim, nëpërmjet punësimit të tyre me kontratë të përkohshme 1 (një)-vjeçare. Procesi i përzgjedhjes dhe emërimit menaxhohet nga Kryeministria, ministrinë e linjës dhe institucionet e tyre të varësisë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë Kryeministrisë apo ministrisë që ka bërë shpalljen publike në mënyrë e përcaktuar në të, jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes në faqen përkatese zyrtare. Kryeministria dhe ministrinë, brenda 15 ditëve pune nga përfundimi i afatit të dorëzimit të dokumentacionit, bazuar në mesataren e studentëve të cilët kanë shprehur interesin krijojnë listat përkatese duke i renditur ata për secilin nga grupet e përcaktuara dhe pozicioneve të krijuara mbi bazën e kriterit të nivelit dhe llojit të diplomës që kërkon pozicioni i punës.



Klaudina Kuçi



"KUNDER NEGOCIATAVE"
"Ne kërkojmë arsim publik falas për të gjitha nivelet (bachelor+master). Z. Rama duhet të kuptojë që ashtu siç nuk negocioi deri më sot me studentët, nuk ka për të negociuar as në vazhdim", - shton Kuçi.

Arlind Qori



"PA MASTER, KAMERIERË"
"Janë 33,000 studentë të nivelit master në universitetet publike. Qeveria ka vendosur që shumica dërrmuese prej tyre të vazhdojë ta paguajë një vit shkollë sa frëngu pulën", - thekson pedagogu.

Taulant Muka



"PROPAGANDA NGA RAMA"
"Gjithçka tha zoti kryeministër e kishte propagandë. Kryeministri e tha qartë: Unë dua të kap protestën e studentëve, pra jo të merrem me plotësimin e zgjidhjes së problematikave që studentët kërkojnë", - u shpreh Muka

Arbjona Çibukaj



"RAMA NA LA PA ZGJIDHJE"
"Rama nuk na tha asgjë. Nuk dha asnjë zgjidhje konkrete për kërkesat tona. Studentët e masterit do të vazhdojnë të paguajnë po njësoj ato tarifë vjetore shumë të larta.", - thekson Çibukaj.

REAGIMET

Kuçi: Arsim publik falas! Pedagogu: Do paguajnë tarifën sa "frëngu pulën"

Voltiza Duro

Ditën e djeshme, qeveria ka miratuar vendimet e përmblidhura në Paktin për Universitetin lidhur me 8 kërkesat e studentëve të IAL-ve publike në vend. Menjëherë pas zbardhjes së vendimeve, studentët kanë reaguuar dhe kanë theksuar se nuk do të tërhiqen nga protesta deri në plotësimin e gjithë kërkesave të tyre. "Ditën e sotme (djeshme) Rama si përherë nuk na tha asgjë. Nuk dha asnjë zgjidhje konkrete për kërkesat tona. Studentët e masterit do të vazhdojnë të paguajnë po njësoj ato tarifë vjetore shumë të larta. Gjithashtu, edhe pesha e fuqisë studentore në zgjedhjen e autoriteteve drejtuese të universitetit do të mbetet në 10%, mjeran. Universitetet publike do të vazhdojnë të vuajnë nga pasiguria financiare, e cila sjell me vete rritjen abuzive të kuotave të studimeve master, lëshimin e notës dhe komercializimin e jetës universitare", - thekson studentja Arbjonja Çibukaj për "Gazeta Shqiptare". Më tej, kjo e fundit shton se tarifën e studimeve mund të rriten që vitin e ardhshëm si rezultat i pakësimit të buxhetit për universitetet publike, të cilat sipas studentëve, do të vazhdojnë të jenë të varura nga qeveria dhe të pavarura nga studentët. "Në janar protestat do të vazhdojnë mbështetur në dëshirat dhe interesat e studentëve. Mënyra se si do të vazhdojë protesta nuk janë ende të qarta, por ka ide të ndryshme si bojkoti, protesta në rrugë, mospagimi i tarifës vjetore etj.", - bën me dije studentja për "GSH". Lidhur me vendimet e qeverisë mbi kërkesat e studentëve, ka reaguuar edhe ish-zv.ministri i Arsimit, Taulant Muka, i cili e ka cilësuar si propagandë çdo falë të thënë nga kryeministri Edi Rama. "Gjithçka tha zoti kryeministër e kishte propagandë. Kryeministri e tha qartë: unë dua të kap protestën e studentëve, pra jo të merrem me plotësimin e zgjidhjes së problematikave që studentët kërkojnë", - tha Muka për "GSH". Më tej, ky i fundit shtoi se studentët duhet të vazhdojnë të protestojnë. "Studentët, nëse kthehen në janar, a do të kenë pedagogë më të kualifikuar, do iu shkojë pedagogu në mësim? Po pedagogu që u ka kërkuar favore seksuale,

Studentët nuk heqin dorë nga protesta: Nuk ka negociatë me Ramën

"Qëndresa do të vazhdojë deri në plotësimin e kërkesave"



Gjatë një proteste të studentëve

iu ka kërkuar lekë për provimet, apo është me lidhje kriminale dhe diplomë false, do jetë ende në mësim dhe presionojë studentin? Asgjë nga këto nuk është e garantuar, asgjë nuk do të ndryshojë për studentin, nëse kthehen në auditorë. Prandaj studentët duhet të protestojnë", - u shpreh ish-zv.ministri i Arsimit për "GSH".

RRËZIMI I LIGJIT

Studentët vazhdojnë të mos tërhiqen nga qëndrimi i tyre, duke theksuar se e vetmja mënyrë për të plotësuar kërkesat e tyre është rrëzimi i ligjit për arsimin e lartë. "Ne nuk morëm përgjigje për asnjë nga 8 pikat që i kemi parashtruar këtij të fundit. Ne kërkojmë abrogimin e Ligjit të Arsimit të Lartë sepse të 8 kërkesat tona janë pjellë e tij. Dhe në u plotësohin me rigorozitet të teta kërkesat, ligji është formuluar në një mënyrë të tillë kaotike, që vazhdimisht do të sjellë problematika të reja njëra pas tjetrës. Por, përgjigje-

ja e Ramës mbi këtë pikë ishte "Jo, Ligji i Arsimit nuk preket", - thotë studentja Klaudina Kuçi për GSH. Më tej, ajo thekson se studentët kërkojnë arsim publik falas për të gjitha nivelet. "Ne kërkojmë arsim publik falas për të gjitha nivelet (bachelor+ master). Ndërkohë që ai na ritheksoi (sepse na e kish të përmendur dhe më parë), do ketë përgjysmim të tarifës (thekso këtu vetëm në nivelin bachelor), përkohësisht dhe arsim falas vetëm për studentët me mesatare mbi 9.00 dhe ata me ndihmë ekonomike. Po për të tjerët? Ndërsa për studentët e masterit që e kanë tarifën për të vënë duart në kokë, as nuk denjoi t'i përmendte. Kërkuam dyfishim të buxhetit të shtetit për arsimin e lartë. Përfshijmë këtu kartën e studentit, kartë e cila ekziston thuajse në çdo vend të botës, ndërkohe nën madhnia tha që po punojmë për të. Kërkuam përmirësim të kushteve të konvikteve dhe ai na tha që

do përmirësohen brenda mandatit të qeverisë. Z. Rama duhet të kuptojë që ashtu siç nuk negocioi deri më sot me studentët, nuk ka për të negociuar as në vazhdim. Kërkesat tona janë të panegociueshme. Dhe rezistenca studentore ka për të vazhduar dhe në ditët në vijim", - shton Kuçi. Edhe pedagogu Arlind Qori ka reaguuar mbi vendimet e qeverisë. "Janë 33,000 studentë të nivelit master në universitetet publike! Qeveria ka vendosur që shumica dërrmuese prej tyre të vazhdojë ta paguajë një vit shkollë sa frëngu pulën. Ndonëse ata nuk janë frëngj, as arsimi pulë. Qeveria ka vendosur të ulë përkohësisht dhe me kusht tarifën. Po me t'u regjistruar në master, do të vazhdojnë të paguajnë deri në 115,000 lekë (të reja) në vit. Qeveria mendon se ndjekja e studimeve master është punë e qejfi, ndonëse studentët e dinë mirë se pa master, mund të gjejnë punë vetëm si kamerierë", - thekson pedagogu për "GSH".

ANALIZA E STUDENTËVE MBI VENDIMET E QEVERISË:

1. Shumica dërrmuese e studentëve të masterit do të vazhdojë të paguajë tarifa vjetore nga 60,000 deri në 115,000 lekë (të reja) në vit.
2. Pësia e fuqisë studentore në zgjedhjen e autoriteteve drejtuese të universitetit do të mbetet në 10% mjeran. Vota e një pedagogu do të vijojë të vlejë rreth 300 herë më shumë se ajo e një studentit. As Rama e askush tjetër nuk ka mundësi të marrë në shqyrtim mbi 20'000 universitetet e kësaj bote. Mirëpo ka plot raste ku pesha e votës studentore është më e lartë se 10%. Një shembull mund të ishte Universiteti Autonom i Barcelonës.
3. Bordet e administrimit të universiteteve do të vazhdojnë të kontrollohen nga qeveria. Premtimi se një prej përfaqësuesve të qeverisë do të zgjidhet prej 3 propozimeve që vijnë nga strukturat përfaqësuese të studentëve është hileqar. Çdo qeveri i ka aq në dorë strukturat burokratike studentore (këshillat studentorë) sa për të futur një vegël të saj në listën 3-emërore.
4. Qeveria nuk ka treguar se sa do të rritet buxheti i shtetit për arsimin e lartë. Rama tha se në vitet në vijim do të ketë ulje të ndjeshme të kuotave për studimet bachelor në universitetet publike. Çdo ulje tarifash bachelori do të shoqërohet me ulje të numrit të studentëve, çka nënkupton se financimi shtetëror për universitetet publike nuk do të ndryshojë ndjeshëm.
5. Në kushtet ku diplomoret private lulëzojnë, çdo ulje kuotash në universitetet publike nuk do të zgjidhë "mbiprodhimin" e gazetarëve apo juristëve, por thjesht do t'i shtyjë kandidatët për gazetarë dhe juristë drejt diplomoreve private, duke sjellë miliona euro shtesë në listën 3-emërore.
6. Mbi të gjitha, qeveria konsideron të panegociueshëm jo vetëm rrëzimin e ligjit të arsimit të lartë, por edhe ndryshimin e pjesës së tij:
 - a. Universitetet publike do të vazhdojnë të vuajnë nga pasiguria financiare, e cila sjell me vete rritjen abuzive të kuotave të studimeve master, lëshimin e notës dhe komercializimin e jetës universitare.
 - b. Diplomoret private do të kenë sërish mundësi të fusin duart në buxhetin e shtetit.
 - c. Tarifën e studimeve mund të rriten që vitin e ardhshëm si rezultat i pakësimit të buxhetit për universitetet publike.
 - d. Universitetet do të vazhdojnë të jenë të varura nga qeveria dhe të pavarura nga studentët.

Mbledhja do miratojë axhendën politiko-organizative të PS për janar-qershorin

Zbardhet axhenda e Asamblesë Kombëtare, PS ngre shtabet elektorale

Rama pritet të deklarohet për ndryshimet në qeveri

Partia Socialiste ndez motorët për organizimin fushatës zgjedhore me qëllim fitoren e zgjedhjeve të ardhshme vendore. Pikërisht në funksion të këtij qëllim, Partia Socialiste do të mbledhë nesër Asamblesë Kombëtare, e cila ndër të tjera do të diskutojë dhe do të miratojë disa vendime të rëndësishme sa i përket organizimit të partisë për zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Mbledhja do të nisë në orën 10 paradite dhe në total do të ketë 8 pika apo çështje të ndryshme diskutimi. Ajo si gjithmonë do të nisë me një pjesë të hapur për mediat gjatë të cilët kryetari i Partisë Socialiste, Edi Rama do të mbajë dhe fjalimin e tij, ku pritet të parashtrijë ndër të tjera dhe një sërë masash të tjera për t'u përgjigjur edhe shqetësimeve dhe problematikës që nxori në pah protesta e studentëve dhe që kanë të bëjnë me qeverisjen e vendit dhe raportin e saj me qytetarët. Fjalimi i Ramës pritet me interes, pasi ashtu siç edhe ka paralajmëruar ai vetë, gjatë kësaj mbledhje ai mund të shpallë edhe ndryshimet e mundshme dhe të përfolura jo pak gjatë këtyre kohëve në kabinetin e tij qeveritar. Ndërkohë që pas fjalës së Ramës, Asambleja do të vijojë pikat e tjera të rendit të ditës i miratuar disa ditë më parë nga Kryesia e Partisë Socialiste. Kështu Asambleja Kombëtare do të diskutojë dhe miratojë më pas për miratimin e axhendës politiko-organizative të Partisë Socialiste për periudhën janar-qershor. Pra, bëhet fjalë për një dokument shumë të rëndësishëm, pasi në të do të përcaktohet me



afate konkrete zbatimi i strategjisë së socialistëve gjatë gjithë periudhës nga Janari deri në zgjedhjet vendore. Jo vetëm kaq por në funksion të zgjedhjeve të ardhshme për pushtetin vendor, Asambleja do të miratojë dhe një tjetër vendim shumë të rëndësishëm. Ai ka të bëjë me krijimin dhe funksionimin e shtabeve elektorale në të gjitha nivelet për zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019. Vendimi do të përcaktojë nivelet e funksionimit të këtyre shtabeve

dhe përbërjen e tyre. Por që partia të jetë gati në çdo nivel për fushatën e ardhshme elektorale Asambleja Kombëtare do të diskutojë dhe miratojë edhe vendimin për riformatimin e strukturave organizative vendore të Partisë Socialiste me synim plotësimin e objektivave statutorë për çdo organizatë socialiste. Një tjetër pikë e rëndësishme e mbledhjes së nesërme të Asamblesë Kombëtare është edhe ai për thirrjen e Kongresit të PS-së në 30 mars 2-19. Gjatë këtij

kongresi PS pritet të bëjë edhe zyrtarizimin e kandidatave për kryetar bashkie në të gjithë vendin. Ndërkohë që Asambleja do të ngrëjë dhe një grup pune për amendimin e Statutit të Partisë Socialiste. Nuk dihet se ku do të synojë puna e këtij grupi pune, por është fakt se PS aktualisht nuk ka një Statut të publikuar në faqen e saj zyrtare në internet. Një tjetër vendimmarrje e Asamblesë do jetë edhe ajo për krijimin e regjistrit digital të anëtarësisë së PS-së.

AXHENDA E ASAMBLËSË KOMBËTARE

1. Fjala e kryetarit të partisë Socialiste, Edi Rama
2. Miratimi i axhendës politiko-organizative të Partisë Socialiste për periudhën janar-qershor
3. Miratimin e vendimit "Për riformatimin e strukturave organizative vendore të Partisë Socialiste me synim plotësimin e objektivave statutorë për çdo OS.
4. Miratimi i vendimit për krijimin e Regjistrit Digital të Partisë Socialiste
5. Miratimi i vendimit për krijimin dhe funksionimin e shtabeve elektorale në të gjitha nivelet për zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019.
6. Miratimi i vendimit për thirrjen e Kongresit të PS-së në 30 mars 2-19.
7. Miratimi i vendimit për ngritjen e grupit të punës për Statutin e PS-së.
8. Të ndryshme.

Qeveria rrit me 2 mijë lekë pagën minimale mujore

Rritet paga minimale mujore për të gjithë të punësuarit në institucionet publike ose ato private. Qeveria ka miratuar dje vendimin për përcaktimin e pagës minimale mujore në vlerën e 26 mijë lekëve të rinj. Në fakt, bëhet fjalë për një rritje fare të vogël në krahasim me pagën minimale që ishte në fuqi deri më tani. Kështu vendimi i miratuar një vit më parë nga qeveria parashikonte që paga mujore minimale të ishte 24 mijë lekë. Pra, vendimi i djeshëm i qeverisë e rrit pagën minimale mujore me 2 mijë lekë të reja. "Paga bazë minimale mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë", thuhet në vendimin e qeverisë. Sipas këtij vendimi paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës dhe se paga bazë minimale orare do jetë 149 lekë. Ndërkohë që edhe shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë.



Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare kthehet në agjenci udhëtimesh

Drejtorja e Shërbimeve Qeveritare krahas shërbimit dhe trajtimit të personaliteteve shtetërore vendase dhe të huaja do të ofrojë edhe shërbimet që ofron sot një agjenci e mirëfilltë udhëtimi, por vetëm për institucionet shtetërore. Qeveria në mbledhjen e djeshme ka miratuar edhe disa ndryshime në vendimin për Drejtorinë e Shërbimit Qeveritar, dhe nëpërmjet të cilave i jep kësaj drejtorie atributet e një agjencie udhëtimesh për shitje biletash dhe rezervime e akomodim hotelerie jashtë vendit. "Ofron shërbime si agjenci udhëtimesh, për shitjen e biletave në fushën e transportit ajror dhe rezervimin e akomodimit në hotelerie jashtë vendit, për institucionet e larta shtetërore, Kryeministrinë e ministritë e linjës dhe, me kërkesë të tyre, për Presidencën dhe Kuvendin e Shqipërisë", thuhet në vendimin e qeverisë. Pra, siç parashikon ky ndryshim tashmë kjo drejtori do të luajë rolin e një agjenti tregtar për blerjen e biletave të udhëtimit për zyrtarët dhe institucionet shtetërore, si dhe të bëjë rezervimet për hotele në rastin e udhëtimit jashtë vendit.



U plagos në protestë, qeveria shpërblen me 12 rroga Ina Nukun

Në mbledhjen e djeshme të qeverisë me Vendim të Këshillit të Ministrave është vendosur që efektivja e policisë Ina Nuka do të shpërblehet me 12 rroga mujore. "Me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave vendosi dhënien e ndihmës financiare, në masën e 12 pagave mujore për Ina Gavrosh Nuka, me detyrë oficerë e patrullës së përgjithshme, sektori "Shqiponja", e plagosur në krye të detyrës", shkruhet në vendimin e publikuar nga qeveria. Policia 24-vjeçare u plagos në protestën e banorëve të Astirit përpara parlamentit ku si pasojë e një kapsolle humbi një prej gishtave. Ajo më pas u dërgua menjëherë në Turqi për të marrë trajtim mjekësor më të specializuar. Vendimi për shpërblimin e saj u paralajmërua disa ditë më parë nga kryeministri gjatë takimit që ai pati me efektiven e plagosur.



UNAZA E RE PËRPLASJA

Valentina Madani

Devijimi i Lumit të Lanës përplasi sërish Bashkinë e Tiranës me demokratët. PD akuzon se plani urbanistik ndryshoi me firmën e kryeministrit Rama dhe kryebashkiakut Veliajt, dhe se biznesmeni Edmond Bego i është miratuar faza e parë e ndërtimit, sipas PD-së, plani urbanistik i Tiranës është ndryshuar dhe për këtë PD merr si referencë faktin se projekti i Lanës në vitin 2013 zinte një pjesë të konsiderueshme të ish-serave. Por, Bashkia e Tiranës sqaroi dje se në gjurmën e lumit Lana, në pjesën perëndimore të qytetit, nga ura e Shkollës Teknologjike deri ku kryqëzohet me Unazën e Re nuk është dhënë asnjë leje ndërtimi dhe se Plani i Përgjithshëm Vendor i qytetit të Tiranës nuk ka ndryshuar. Drejtoresha e Drejtorisë së Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë e Tiranës, Frida Pashako, shprehet se projekti për disiplinimin e lumit të Lanës bëhet nga inxhinierë hidroteknikë dhe se në këtë zonë nuk ka asnjë kërkesë për leje ndërtimi nga subjekte private. Bashkia e Tiranës nënvizon se projekti i disiplinimit të Lumit të Lanës është i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe se ai nuk ka asnjë lidhje me projektin tjetër për ndërtimin e Unazës së Re. "Ky projekt nuk ka lidhje me Unazën, janë dy projekte të ndryshme. Të dyja projektet janë të parashikuara në Planin e Përgjithshëm Vendor. Madje, projekti i Unazës ka disa vite që ka nisur, ndaj nuk mund të themi janë dy projekte të lidhura", tha Pashako. Gjithashtu, nisur edhe nga deklaratimet e opozitës, Bashkia e Tiranës shpjegon se nuk ka asnjë ndryshim në Planin e Përgjithshëm Vendor që është miratuar në vitin 2017. "Plani i Përgjithshëm Vendor që kemi aktualisht në fuqi është miratuar në vitin 2017 nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Si hartimi i PPV, ashtu edhe ndryshimi i tij kërkon një proces shumë të gjatë, ndër-institucional dhe kërkon aprovime në nivele të ndryshme. Aktualisht nuk kemi asnjë nisim për të ndryshuar Planin e Përgjithshëm Vendor të Tiranës", u shpreh Pashako.

REGIMI

PD hodhi poshtë deklaratat e bashkisë, duke i kujtuar asaj se shqiptarët kanë parë me sytë e tyre dokumentet zyrtare të paraqitur nga PD që provojnë se Plani Urbanistik i Tiranës u ndryshua me firmat e Edi Ramës dhe Erion Veliajt për të favorizuar tokën ku Edmond Bego ka parashikuar të ndërtojë projektin 60 milionë euro. "Pas Arben Ahmetajt, sot i erdhi radha Erion Veliajt për të bërë rolin e budallait për

PD: Bëni rolin e budallait, faktuar me dokumente zyrtare si ndryshoi plani për Begon

Akuzat për planin urbanistik, bashkia: S'ka asnjë leje ndërtimi

"Begos iu miratua faza e parë e ndërtimit"



Kreu i PD-së Lulzim Basha me banorët e Astirit

OPOZITA

"Shqiptarët kanë parë me sytë e tyre dokumentet zyrtare të paraqitura nga Partia Demokratike, që provojnë se Plani Urbanistik i Tiranës dhe projekti për lumin e Lanës u ndryshuan me firmat e Edi Ramës dhe Erion Veliajt për të favorizuar tokën ku Edmond Bego ka parashikuar të ndërtojë projektin 60 milionë euro", thuhet në reagimin e PD.

Meta: Të edukojmë të rinjtë me punë. Kultivuan kanabis dhe sot janë në burgje

Meta: Përgjegjshmëri dhe vëmendje për rritjen e pensioneve

Presidenti i Republikës, Ilir Meta kërkoi dje me shumë përgjegjshmëri nga institucionet e shtetit për kujdesin ndaj moshës së tretë. Gjatë një takimi me pensionistë, kreu i shtetit u shpreh i ndërgjegjshëm për problemet që po has kjo kategori. "Emigracioni, ashtu sikurse ka pasur aspektet e veta pozitive në fillim, tashmë është kthyer në një problem shumë të madh. Tani jemi të ndërgjegjshëm edhe për problemet e mëdha të vetmisë me të cilat ndeshen shumë familjarë e prindër. Kemi edhe problemet e tjera, që kanë të bëjnë me përballimin e pensioneve, të skemës së pensioneve dhe rritjen e



tyre në të ardhmen, që janë probleme objektive ndaj të cilave duhet të tregojmë shumë vëmendje", deklaroi z.Meta. Kreu i shtetit tha se duhet të mësojmë nga përvoja e pensionistëve për të edukuar brezin e ri. "Në të

projektin luksoz rezidencial 60 milionë euro të trafikantit të drogës pranë Unazës së Madhe.

Shqiptarët kanë parë me sytë e tyre dokumentet zyrtare të paraqitur nga Partia


gjithë duhet të tregojmë me shumë mundësi, jo vetëm për të përfutur nga përvojat dhe aftësitë tuaja në të kaluarën, por edhe t'i investojmë këto përvoja për ta edukuar me mirë brezin e ri, me ndjenjën e punës, të ndershmërisë, të korrektesisë, të bërjes së punës me dinjitet dhe përgjegjshmëri e jo të gjetjes së rrugëve të lehta në jetë, të cilat sjellin pastaj një kosto shumë të madhe për të rinjtë vetë, për familjet e tyre, por edhe për të gjithë shoqërimin", u shpreh kreu i shtetit. Presidenti Meta uroi të gjithëve të pranishmit në këtë atmosferë festash për sa më shumë shëndet, jetë të gjatë dhe solidaritet me njëri-tjetrin.

Demokratike, që provojnë se Plani Urbanistik i Tiranës dhe projekti për lumin e Lanës u

BASHKIA

Drejtoresha e Drejtorisë së Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në Bashkinë e Tiranës, Frida Pashako, shprehet se projekti për disiplinimin e lumit të Lanës bëhet nga inxhinierë hidroteknikë dhe se në këtë zonë nuk ka asnjë kërkesë për leje ndërtimi nga subjekte private dhe se projekti nuk ka lidhje me projektin e Unazës së Madhe.

ndryshuan me firmat e Edi Ramës dhe Erion Veliajt për të favorizuar tokën ku Edmond Bego ka parashikuar të ndërtojë projektin 60 milionë euro. Shqiptarët e kanë parë vetë dhe nuk kanë nevojë për mashtrimet banale të Erion Veliajt se projekti i Lanës i vitit 2013 zinte një pjesë të konsiderueshme të ish-serave", thuhet në reagimin e PD-së. Sipas demokratëve: "Shqiptarët kanë parë gjithashtu se projekti i vitit 2017 shmang plotësisht ish-serat, vetëm pasi kjo pronë u privatizua në mars 2016 me paratë e trafikantit të drogës. Të gjithë i kanë parë 4 faturat prej 1.5 milionë euro të paguara për privatizimin nga Edmond Bego për llogari të Ministrisë së Financave. Erion Veliajt mashtron paturpësisht kur thotë se nuk ka asnjë aplikim për leje ndërtimi në atë zonë". Partia Demokratike ka paraqitur dokumente zyrtare që provojnë se aplikimi për leje ndërtimi nga Edmond Bego në zonën e ish-serave pranë Unazës së Madhe e ka kaluar fazën e parë të miratimit dhe tani leja është vetëm formalitet. "Afera e projektit luksoz rezidencial 60 milionë euro provon se Erion Veliajt nuk ka asnjë ndryshim nga Edi Rama. Ai është njësoj në shërbim të trafikantëve të drogës, për të shembur shtëpitë e qytetarëve. Për të ndërtuar pallatet e kirit dhe për të pastruar paratë e pista të kirit dhe korrupsionit", thuhet në reagimin e PD-së.



Bregu i Lumit, IMT afat banorëve deri me 28 dhjetor për të liru shtëpitë

Një pjesë e banorëve të Bregut të Lumit do të mbeten pa shtëpi për Vitin e Ri. Për shtatë familjet e para të kësaj zone ka ardhur paralajmërimi për të liru shtëpitë deri më 28 dhjetor. Të mërkurën banorët janë mobilizuar për të mbrojtur shtëpitë e tyre. Një banor i zonës shprehet: "Kemi kërkuar këto vlerësime që të dalin dhe jo të thotë që tani mund të dalësh në rrugë". Banorët kanë denoncuar përdorimin e 2 standardeve duke vënë në pikëpyetje transparencën e projektit. "Nuk ka dy standarde, deri këtu të shpronësohen, kurse këtu i vë gjobë. Kam dyshime se këto lekë të lojit të tretë janë vjedhur", shprehet një tjetër banor. Në të njëjtën kohë, ata janë shprehur se protestat do të vijojnë dhe do të përkrahë. "Ne do marrim fëmijët, bantaniat dhe do flemë para bashkisë ose Kryeministrit", tha një tjetër banor. Banorët e Bregut të Lumit preken nga projekti për zgjatimin e bulevardit dhe protestojnë prej më shumë se 3 javësh për të kërkuar shpronësimin.



Protesta në ditën e 53 tek Unaza. Basha: Veliaj të nxjerrë planin vendor të Tiranës

Banorët e "Astirit": Dëmshpërblim 100% dhe anulim të projektit

"Plani ndryshoi për pronën e një trafikanti"

Valentina Madani

Protesta e banorëve të zonës së "Astirit" hyri dje në ditën e 53-të. Ata kërkojnë dëmshpërblim 100% dhe anulimin e plotë të projektit të Unazës së Madhe. Banorët bllokuan rrugën, ndërkohë që paralelisht me protestën, një makinë është përfshirë nga flakët në vendin ku banorët kanë bllokuar rrugën. Mësohet se nga zjarri që ka rënë në makinë nuk kishte të lënduar. Ata kërkuar sërish dhe anulimin e projektit për ndërtimin e Unazës së Madhe. Banorët e kanë quajtur këtë projekt një aferë korruptive. Në protestën e tyre banorët e zonës së "Astirit" nuk kërkojnë vetëm dëmshpërblim në vlerë 100% të banesave dhe bizneseve të prekura nga projekti i Unazës së Madhe, por anulimin e plotë të projektit. Banorët e Unazës së Madhe bllokuan rrugën për të gjitha mjetet, duke i kërkuar që të bashkon me protestën e tyre.

MBËSHETJA
Në mbështetje të banorëve mbrëmë ishte sërish kreu i opozitës, Lulzim Basha. Ai kërkoi dëmshpërblim për banorët e Unazës së Re në kryeqytet, për stresin që sipas tij, kanë pësuar nga kryeministri Edi Rama. Basha denoncoi se me firmën e kryebashkiakut të Tiranës, Erjon Veliaj dhe kryeministrit Edi Rama, në 2017-ën, është ndryshuar plani urbanistik i 2013-ës, duke zhvendosur shtratit e Lanës. "Kjo - tha Basha - është bërë për t'i hapur rrugë prishjes së shtëpive të mbi 200 familjeve, për të vetmen arsye që prona e privatizuar me firmën e Arben Ahmetajt, me kontributin 1.5 mln euro të derdhura në emër të një trafikanti të dëbuar droge të mos cenohet dhe aty të zhvillohej një projekt 60 mln euro pallate shumëkatëshe. Veliaj bëri budallain. Afera u denoncua nga PD. Është ndryshuar plani vendor i Tiranës, që prona e privatizuar nga Ahmetajt të mos cenohet dhe të zhvillohet projekti 60 milionë euro. Aferë më ashqare se kaq nuk ka. Pronat e një trafikanti droge nuk preken, por zhvillohen me firmë të Veliajt. I ftoj mediat të bëjnë



ARRSH rihap garën për lotin e Unazës së RE

PD: Marku të largohet, nëse s'ka guxim të hetojë skandalin

Autoriteti Rrugor Shqiptar rihapi dje procedurat e garës për lotin 1 të Unazës së Madhe të Tiranës, për "Rehabilitimin e segmentit rrugor 'Mbikalimi' Pallati me Shigjeta të Rrethrotullimit Shqiponja", pas zgjidhjes së kontratës me bashkimin e operatorëve "DH Albania" & "Biba X". "DH Albania" u përjashtua, duke iu zgjidhur kontrata, pasi rezultoi se kishte mashtruar me dokumentacionin. Nga ana e tij, deputeti i PD-së, Klevis Balliu nga protesta e Unazës së Re i kërkoi dje prokurores së përgjithshme të përkohshme, Arta Marku që të hetonte lidhur me skandalin e falsifikimit të dokumenteve të firmës fituese të tender-



it të projektit "DH Albania". "Qëndresa juaj është heroike. Rama është autori i vjedhjes. Çdo qytetar duhet t'i bashkohet Unazës së Re për t'i dhënë stop vjedhjes. Tëpsia e tij nuk ekziston më, tani qytetarët vendosin. Pse nuk kemi të arrestuar lidhur me aferën? Arta Marku të largohet nëse nuk ka guxim të hetojë, në të kundërt do ta largojnë qyteta-

rët. Falënderoj banorët për qëndresën e tyre. Po qëndruan, do të fitojmë dhe ata do të dëshutojnë", - theksoi z.Balliu. Në protestën e tyre, banorët e zonës "Astirit" nuk kërkojnë vetëm dëmshpërblim në vlerë 100% të banesave dhe bizneseve të prekura nga projekti i Unazës së Madhe, por anulimin e plotë të projektit.

SHKURT

Kryemadhi, shqiptarëve: Dilni në protesta, rrëzoni kryeministrin

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, takoi dje strukturat e partisë në qytetin e Fierit. Në fjalën e saj, Kryemadhi akuzoi kryeministrin e vendit, Edi Rama se ka gënjyer shqiptarët lidhur me të gjitha premtimet që ka dhënë dhe se ata nuk do t'ia falin këtë gjë. "Sot dëgjonim një konferencë të kthyer në monolog. Rama gënjente. Ashtu siç ka gënjyer parlamentin, ndërkombëtarët etj. Me paturpësinë më të madhe, ky njeri kërkon të mashtrtojë shqiptarët. Ai kalon çdo normë. QS ka 27 godina, një godina kushton minimum 3 mln për të restauruar. Kë gënjën? Edi Rama gënjen ashtu siç ka gënjyer gjithë këto vite. Më thonë nëse TVSH-në tek fabrika e ujit e kemi 6%. Po i detyron shqiptarët që të largohen nga Shqipëria. Ai ka gënjyer gjithë karrierën e tij politike. Punonjësit e policisë së Shtetit kërkojnë rrugën e 13-të, e njëjta gjë ka ndodhur edhe me infermierët. Shqiptarët nuk kanë për t'ia falur, sepse nuk ia falin dot të ardhmen e fëmijëve të tyre. Sot naftëtarët shqiptarë sorollaten për të marrë statusin e naftëtarit, e marrin kushërinjtë e anëtarëve të PS-së që nuk kanë punuar një ditë në naftë", - theksoi Kryemadhi. Por gjatë takimit, kryetarja e LSI-së nuk ka lënë pa përmendur edhe protestën e studentëve, duke dhënë edhe parashikimin e saj për vitin 2019. "Unë kërkoj angazhimin tuaj për t'u përfshirë në protestat jo vetëm të studentëve, por në të gjitha. Vetëm të gjithë mund t'ia dalim. 2019-ta, vit i vështirë ekonomikisht, por nëse ne jemi bashkë, do të jetë një vit shumë i thjeshtë politikisht", - tha Kryemadhi.

Manjani, Ramës: Autokritika shahet me vaj e uthull

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, teksa analizon situatën që po ndodh në vend, komentoi deklaratën e kryeministrit Edi Rama se PS kishte bërë edhe gabime. Përmes një statusi në "Facebook", Manjani përmendi kështu që nga shëndetësia, arsimit, apo dhe infrastruktura. Po ashtu, Manjani theksoi se autokritika e tipit komunist nuk mund të ahahet as me vaj dhe as me uthull. "Është e ndyrë! E shpifur fare! Kjo qeveri ka rënë në çdo aspekt, jo thjesht prej ministrave kulla, por prej modelit më të keq qeverisës që instaloi Edi Rama dhe Rilindja e tij. Nuk mund ta kalojë këtë situatë krize, nga më të rëndat, as me grupe të brendshme armiqësore e as me autokritika komuniste. Duhet të marrë përgjegjësinë që i takon, që në fakt është e gjitha për e mbi të", shkruan Manjani.

është ky. Rama tha do e kapë protestën. Kjo është mendësia e tij. Kap drejtësinë, prokurorinë, të gjitha institucionet e shtetit. Studentët e kanë dëgjuar mirë, bëhen afera duke kapur institucionet", theksoi kreu i PD-së. Basha kërkoi anulimin e projektit dhe dëmshpërblimin e banorëve tek Unaza, "për stresin e jashtëzakonshëm dhe dëmet materiale e morale që kanë përjetuar si re-

zultat i dhunës policore, fizike, kriminale dhe psikike të ushtruar nga Edi Rama". "Dhe për të bërë të mundur që taksat e shqiptarëve, të shkojnë për shqiptarët dhe jo oligarkët dhe kriminelët", deklaroi z.Basha. I pyetur nga gazetarët, Basha tha se Partia Demokratike do të mbështesë edhe protestën e datës 28 dhjetor, që do të zhvillohet nga diaspora.

Federata Europiane e Gazetarëve dhe tri të tjera, letër qeveritarëve

Ligji për 'web'-et, të huajt Ramës e Gjonit: Tërhiquni

"Iniciativa juaj është kundër rekomandimeve të OSBE"

Katër organizata i kanë dërguar kryeministrit Edi Rama e ministres së Drejtësisë, Etilda Gjonaj, një letër të hapur, ku i kërkojnë tërheqjen nga ligji për regjistrimin, mbikëqyrjen, gjobitjen e mbylljen e portaleve 'online'. Kjo iniciativë është prezantuar pak kohë më parë nga kreu i qeverisë dhe lidhet me atë që ai e quan "paketa antishpije". Federata Europiane e Gazetarëve, Qendra Europiane për Liri të Medias dhe të Shtypit, PEN International dhe Reporterët pa Kufi i kanë kërkuar Ramës të tërhiqet. "Iniciativa juaj është kundër rekomandimeve të OSBE-së dhe shkakton shqetësime të mëdha për ne", shkruhet në letër. "Nëse projektligjet e propozuara miratohen nga parlamenti, ato do të dëmtojnë rëndë qarkullimin e lirë të informacionit dhe do të kenë efekt pengues për medianë në internet e do të kufizojnë të drejtën e qytetarëve shqiptarë për akses në



informim", shkruhet aty. "Shprehim zhgënjim të thellë se ky ligj është hartuar pas dyerve të mbyllur

ra, pa përfshirë gazetarë dhe organizata të shoqërisë civile përgjatë procesit të hartimit. Ne ju kërkojmë

ju të ndërprisni menjëherë iniciativën për të amenduar këto dy projektligje dhe të përfshini

KERKESA

Federata Europiane e Gazetarëve, Qendra Europiane për Liri të Medias dhe të Shtypit, PEN International dhe Reporterët pa Kufi i kanë kërkuar Ramës të tërhiqet. "Iniciativa juaj është kundër rekomandimeve të OSBE-së dhe shkakton shqetësime të mëdha për ne", shkruhet në letër. "Nëse projektligjet e propozuara miratohen nga parlamenti, ato do të dëmtojnë rëndë qarkullimin e lirë të informacionit dhe do të kenë efekt pengues për medianë në internet e do të kufizojnë të drejtën e qytetarëve shqiptarë për akses në informim", shkruhet aty.

Këshillin e Europës në çfarëdolloj iniciative që prek lirinë e shprehjes, medianë dhe gazetarët", vijon më tej letra. Projektligjet e hartuara nga qeveria parashikojnë krijimin e një regjistri të medias 'online' pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) si dhe vendosjen e përmbytjes së medias 'online' nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Medias Audiovizive dhe një Këshilli Ankesash, një komision pranë AMA, i cili do të ketë fuqinë të gjykojë nëse media është e njohshme apo e paanshme, nëse ajo cenon moralin publik apo jo dhe nëse e gjykon të arsyeshme, mund të vendosë gjoba deri në 8 mijë euro dhe të urdhërojë mbylljen e këtyre mediave.

gazetarët, shoqërinë civile, përfaqësuesin e OSBE-së për Lirinë e Medias, Bashkimin Europian dhe



REPUBLIKA E SHQIPERISE GJYKATA KUSHTETUESE KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

RISHPALLJE VENDI VAKANT

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr. 101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" rishpall vendin vakant për pozicionin:

"Përkthyes" në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun

KËRKESA TË POSAÇME:

1. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip;
2. Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët;
3. Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 24 dhjetor deri më 10 janar 2019 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 janar 2019, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 24 dhjetor deri më 10 janar 2019 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.



Mediat: Mafia shqiptare "zapton" Serbinë, në një dekadë pastroi mbi 1 miliard euro

SERBI - Mediat serbe raportojnë se mafia shqiptare ka pastruar më shumë se 1.5 miliardë euro në tregun e pasurive të patundshme në shtetin e Serbisë. Ato shkruajnë se ky pastrim parash është kryer përgjatë një dekade dhe kjo e gjitha me ndihmën e biznesmenëve vendës, të cilët kanë influencë në sektorët të ndry-

shëm, raporton "BalkanWeb". Media shtetërore serbe "B92" duke cituar "Kurir" shkruan se: "Mafia shqiptare në këtë mënyrë "u bë ndoshta lojtari më i madh me një skemë të pastrimit të parave të përfuturara përmes krimit, kryesisht drogës dhe trafikimit të armëve". Ish-drejtori i policisë së Beogradit, Marko Niković

u shpreh se mafiozët shqiptarë pastrojnë nga 80-100 milionë euro në vit, duke blerë toka për ndërtim, investime në pasuri të paluajtshme dhe në fushën e ndërtimit. Kjo veprimtari sipas tyre është ndihmuar nga biznesmenë serbë. "Në këto transaksione, si rregull, shqiptarët nuk shfaqen në pub-

lik asnjëherë. Kjo funksionon me anë të personave të tjerë", theksoi ai. Ndërkohë, ai thotë se shqiptarët përdorin persona me emra si: Petar Petrovic nga Mynihu, i cili shërben si fasadë. Investimet më të mëdha të tyre janë në jug dhe juglindje të Serbisë. Gjithashtu, ai shtoi se klanet shqiptare të drogës përdorin të njëjtën strategji dhe skema për blerjen e pasurive të patundshme në disa vende turistike të Kroacisë, Malit të Zi, si dhe në Bosnje-Hercegovinë.

Dy të rinjtë u qëlluan nga 2 persona të maskuar sapo u futën në makinë

TIRANË

Tronditet Tirana. Një 17-vjeçarë është ekzekutuar me plumb në kokë në një atentat, ndërsa është plagosur rëndë një 23-vjeçar. Mësohet se Briselda Gjinkola dhe Erion Bengo (ishin në lidhje dashurie) kanë qenë duke hipur në makinë, kur dy persona të maskuar kanë qëlluar në drejtim të tyre me breshëri plumbash. Për pasojë dy të rinjtë kanë mbetur të plagosur. Burime zyrtare nga policia e kryeqytetit bënë me dije se ngjarja ka ndodhur mbrëmë në Laprakë dhe se adoleshentja Gjinkola ka ndërruar jetë pak minuta pas mbërritjes në spital. Menjëherë pas sinjalizimit për plagosjen e dy personave, blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet. Parakrisht, policia deklaroi se viktima dhe 23-vjeçari janë plagosur në rrethana ende të paqarta. "Më datë 26.12.2018, rreth orës 18:17, në Laprakë janë plagosur me armë zjarri në rrethana ende të paqarta shtetasit B. Gj., 17 vjeçe dhe E.B., 23 vjeç. Shtetasia B. Gj. ka ndërruar jetë në spital, ndërsa shtetasi E.B. ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore (në koma). Po punohet për zbardhjen e rrethanave, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve", thuhet në deklaratën zyrtare të policisë.

VRASJA

Sipas burimeve nga grupi hetimor, vrasja ka ndodhur në një zonë mes pallatesh dhe jo shumë e ndriçuar. Nga të dhënat paraprake mësohet se dy atentatorët, të maskuar me kapuç, ishin në këmbë, kur nisën të qëllonin me breshëri drejt makinës tip "A class" me ngjyrë gri, ndërsa plumbat goditën dy të rinjtë teksa po hynin në automjetet. Autorët janë filluar nga kamerat e sigurisë së bizneseve pranë vendit të ngjarjes. Po ashtu, plumbat prekën edhe automjetet të tjera që ishin pranë vendit të atentatit, ndërsa ngjarja mund të kishte përmasa edhe më tragjike. Ndonëse të dy shkuan në gjendje vitale për

Atentat në Laprakë, ekzekutohet me plumb në kokë 17-vjeçarja, plagoset i riu

Viktima Briselda Gjinkola vdiq në spital. Bluzat e bardha: 23-vjeçari Erion Bengo është në koma



Vendi ku ndodhi ngjarja



PISTAT E HETIMIT

Burime nga policia pohuan se po hetohet në dy pista për zbardhjen e motivit të ngjarjes. Konkretisht dyshohet se ngjarja mund të ketë ndodhur për motive xhelozie, pasi adoleshentja ka qenë e lidhur më parë me një person tjetër, ose për shkak të konflikteve të mëparshme që ka pasur 23-vjeçari Erion Bengo.

AUTORET E KRIMIT

Grupi hetimor bazuar edhe në pamjet filmike të siguruar nga kamerat e sigurisë ka mundur të identifikojë dy autorët e krimit, ndërsa po punohet për kapjen e tyre. Mësohet se dy atentatorët, të maskuar me kapuç, ishin në këmbë, kur nisën të qëllonin me breshëri drejt makinës tip "A class" me ngjyrë gri,

jetën, 17-vjeçarja Briselda Gjinkola ndërroi jetë në spital. Aktualisht 23-vjeçari Erion Bengo ndodhet në koma, ndërsa thuhet se përveç plumbave që ka marrë në kokë, ka plagë edhe në trup. Policia e ka pasur të vështirë si fillim të identifikojë dy të rinjtë, pasi ata u paraqitën në spital pa mjete identifikimi. Identifikimi ka qenë i vështirë

dhe për faktin se viktima kishte marrë plumba në kokë (fytyrë). Ndërkaq, grupi hetimor bazuar edhe në pamjet filmike të siguruar nga kamerat e sigurisë ka mundur të identifikojë dy autorët e krimit, ndërsa po punohet për kapjen e tyre. Sipas burimeve nga policia po hetohet në dy pista për zbardhjen e motivit të ngjarjes. Konkretisht dyshohet

2 vite më parë, Erion Bengo shantazhoi ish-të dashurën me video intime

TIRANË - Pas atentatit të ndodhur mbrëmë në Laprakë janë zbuluar detaje të reja. Mësohet se Erion Bengo, 23-vjeçar, i cili mbeti i plagosur rezultoi me precedent të mëparshëm penalë. Bengo është arrestuar para dy vitesh për veprën penale "shtrëngim me anë të kanosjes për dhënie pasurie". I riu (në atë kohë 21 vjeç) është akuzuar nga policia se në bashkëpunim me 25-vjeçarim me inicialet A.S., ka shantazhuar ish-të dashurën K.L. se, do t'i publikonte një video intime, nëse ajo nuk i jepte 2.000 euro. Pas denoncimit të vajzës, blutë vunë në pranga Erion Bengon për shantazh.



se ngjarja mund të ketë ndodhur për motive xhelozie, pasi adoleshentja ka qenë e lidhur më parë me një person tjetër, ose për shkak të konflikteve të mëparshme që ka pasur 23-vjeçari Erion Bengo (në vitin 2016 është prangosur për shantazh me video intime).

konflikteve të mëparshme që ka pasur 23-vjeçari Erion Bengo (në vitin 2016 është prangosur për shantazh me video intime).

Kamioni rrezikonte të binte në humnerë, shpëtohet shoferi turk

DIBËR - Një shofer turk është ndihmuar nga Policia Rrugore e Dibërës në bashkëpunim me disa banorë të zonës, pasi rrezikonte të binte në humnerë. Në vendin e qajtur ura e "Doçit" në Kastriot të Dibërës, nga ora 18:00 deri në orën 23:30 të së martës, nga ana e shërbimeve të Policisë Rrugore dhe tre banorëve të zonës i është dhënë ndihmë një drejtuesi mjeti me inicialet M.T., (shtetas turk), pasi mjeti i tij tip "kamion" doli nga rruga në një urë të ngushtë dhe rrezikonte të binte në humnerë. "Pas organizimit të punës nga shefi i Trafikut Urban dhe Interurban, punonjës të Policisë Rrugore, të ndihmuar nga banorë të zonës, pavarësisht kohës të ftohtë e reshjeve të shiut, i dhanë ndihmën e nevojshme dhe nxorën mjetin. Policia Rrugore e ka ndihmuar drejtuesin e mjetit deri në qendrën e banuar, ku dhe morën masa për të ndihmuar drejtuesin e kamionit që të riparonte dëmin e shkaktuar, si dhe i siguruan atij ushqim e mbështetje deri në largimin nga zona e Dibërës. Shtetasi turk gjatë një interviste për një media shprehu falënderime për Policinë Rrugore dhe banorët për ndihmën e dhënë", - thuhet nga policia.

Deputeti i PD-së: Skandale të njëpasnjëshme, Manastirliu bën takime me dyer të mbyllura

Voltiza Duro

Qeset që përdoren për të mbuluar këpucët shërbejnë si dyer të inkubatorëve në maternitetin "Koço Gëlozheni" në kryeqytet. Denoncimi ka ardhur ditën e djeshme nga deputeti i Partisë Demokratike Bardh Spahia, i cili e ka ilustruar edhe me foto situatën skandalozë në këtë maternitet. "Situata që ilustron me foto nga materniteti Koço Gëlozheni është realiteti mjeran në të cilin është katandisur shërbimi mjekësor nën qeverinë Rama. Qeset higjienike të këpucëve shërbejnë si mjete rrethore, si dyer për inkubatorët e bebeve. Fasada e mjekësisë së rilindur fsheh një panoramë kaq primitive, pikërisht në sektorin ku nis jeta. A e ka parë ministria këtë situatë sot (dje) në takimin me dyer të mbyllura që zhvilloi me drejtuesit e këtij materniteti? Si mund të mbyllet sytë para pamjeve të tilla? Kjo është një situatë e përsëritur, e denoncuar edhe më herët nga ne dhe nga media, por që duket nuk i bën përshtypje as ministres e as kryeministrit. Një situatë që rëndohet nga indiferenca mizore e një qeverie, që prioritet ka PPP-të e jo shëndetin e qytetarëve të vet. Ato foto janë fytyra e shëmtuar e një qeverie që tashmë nuk ka

Skandali, qeset e këpucëve shërbejnë si dyer inkubatorësh te 'Koço Gëlozheni'

Bardh Spahia: Situata e rënduar nga indiferenca e qeverisë



Gjendja e Inkubatorëve në maternitetin 'Koço Gëlozheni'



SITUATA

Një situatë që rëndohet nga indiferenca mizore e një qeverie, që prioritet ka PPP-të e jo shëndetin e qytetarëve të vet. Ato foto janë fytyra e shëmtuar e një qeverie që tashmë nuk ka asnjë ndjeshmëri njerëzore", - thotë Spahia në një prononcim për "Gazeta Shqiptare".

asnjë ndjeshmëri njerëzore" - thotë Spahia në një prononcim për "Gazeta Shqiptare". Denoncimet e mëparshme Edhe më parë, Bardh Spahia ka denoncuar situatën në

maternitetin Koço Gëlozheni në Tiranë. Përmes një postimi në rrjetin social 'Facebook', më herët deputeti Spahia shkruante se ministria e Shëndetësisë Ogerta Manas-

tirliu ndodhej në një mbledhje me dyer të mbyllura me drejtuesit e maternitetit "Koço Gëlozheni". "Është e qartë që edhe mbas skandaleve të njëpasnjëshme dhe

gjendjes dramatike në institucionet që ajo drejton, shqetësimi i vetëm i ministres është të mbajë të fshehtë situatën", -thotë Spahia. Ky i fundit disa ditë më parë ka akuzuar min-

istren e Shëndetësisë se bën propagandë me fatkeqësinë e shqiptarëve. Sipas tij, gjendja ku ndodhet shëndetësia sot nuk ndryshon aspak nga një vit më parë.

TENDER NOTIFICATION

CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT "AIRFIELD 2020" PROJECT TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for consulting services for construction management of "Airfield 2020" project.

TIA is looking to contract a company that will provide the consulting services which consist of technical and administrative assistance and support on behalf of TIA for monitoring, managing and supervising the construction works that will be part of the "AIRFIELD 2020" PROJECT.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e-mail, to all below e-mail address.

Upon receipt of the e-mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form. The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e-mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked: "CONSULTING SERVICES FOR CONSTRUCTION MANAGEMENT" "AIRFIELD 2020" PROJECT

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 11 January 2019.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialimema@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Veliaj: Do të ketë burg e sanksione të tjera

Gjoha për ata që shfrytëzojnë fëmijët për të marrë para përmes lypjes

Të gjithë ata që shfrytëzojnë fëmijët për qëllime përfitimshme përmes lypjes, do të ndëshkohen me gjobë. Kjo deklaratë është bërë ditën e djeshme nga kryebashkiaku i Tiranës Erion Veliaj gjatë shpërndarjes së dhuratave për fëmijët me aftësi të kufizuara. "Një njeri që lyp s'ka as llogari bankare, as numër NIPT-i, as adresë ku mund t'i vëmë gjobë, as nuk e kemi menduar t'i vëmë gjobë, por dikush që shfrytëzon lypësit, që qëllimisht e merr dikë dhe e trajton si bankomat, e nxjerr në rrugë për ta shfrytëzuar, për t'i futur duart në xhepa. Sigurisht, për këtë jo vetëm gjobë, por edhe burg, edhe sanksione të tjera, sepse askush nuk ka të drejtë, qoftë edhe fëmijën e vet, ta shfrytëzojë për të marrë para nga rruga. Ndaj, jo vetëm që s'ka gjobë për lypësit, por përkundrazi kemi marrë përsipër programin social më radikal që është marrë ndonjëherë në qytetin e Tiranës dhe Republikën e Shqipërisë, ama për ata që i shfrytëzojnë do të jemi të pamëshirshëm. Të mëshir-



shëm me të dobëtit, të pamëshirshëm me ata që abuzojnë dhe që shfrytëzojnë një njeri tjetër për interesin e tyre", theksoi Veliaj. Ky i fundit ftoi edhe kompanitë e bizneset e tjera që vepron në Tiranë që të japin kontributin e tyre në këtë fushatë solidariteti për njerëzit në nevojë. "Mezi pres që edhe këtë vit, shumë studentë vullnetarë apo të tjerë që kanë në zemër të

kontribuojnë, të kenë mundësi ta bëjnë. Na kanë ngelur edhe pak ditë derisa të vijë Viti i Ri, dhe besoj që ka plot kompani të tjera, ndonjëherë është mukajeti, thjesht s'u ka shkruar në mend dhe besoj që kjo e sotmja është një kujtesë edhe për kompani të tjera, për këdo që i ka mundësitë të vërë diçka mënjanë, do i ishim shumë mirënjohës", tha Veliaj.

Ministria e Arsimit harton Kodin e Sjelljes, ja çfarë përmban

Plagjiatura, manipulimi i autorësisë ose deni grimi i rolit të kërkuesve të tjerë në botime do të gjobiten deri në 300 mijë lekë. Ministria e Arsimit ka hartuar Kodin Etik, ndërsa janë përcaktuar në projektligj edhe sanksionet ndaj shkeljeve të integritetit në kërkimin shkencor. Ky projektligj u është dhënë për shqyrtim grupeve të interesit e më pas do kalojë për miratim. Në nënin 31 janë parashikuar shkeljet më të rënda dhe kur ato nuk janë të përsëritura, dënohen me gjobë nga 1 000 000 në 3 000 000 lekë dhe me ndërprerjen e kontratës së punës. Sanksionet arrijnë deri në heqjen e gradës ose e titullit shkencor. Sipas Kodit, sanksionet do të vendosen edhe ndaj udhëheqësve shkencorë, oponentëve apo recensuesve, për punimet a botime që kanë udhëhequr apo vlerësuar. Masa për udhëheqësin është sa 50% e masës për autorin, masa për oponentët dhe recensuesit është sa 30% e masës për autorin. Sipas Ministrisë së Arsimit, Kodi i Sjelljes synon të ruajë, të garantojë dhe të mbrojë pastërtinë dhe integritetin akademik, profesional, institucional, moral dhe shoqëror të institucioneve dhe të pjesëtarëve të komuniteteve akademike e shkencore. "Kodi nisët nga premissa se kërkimi shkencor,

Projektligji i ri, gjoba deri 300 mijë lekë për plagjiatura

Sanksione edhe për drejtuesit e doktoraturës

300

MIJË LEKË

Ndaj autorëve të punimit, oponentëve dhe udhëheqësve shkencorë për të cilët provohet se kanë kryer shkelje të integritetit në kërkimin shkencor, vendosen sanksione financiare deri në 250 mijë lekë, ndërsa shkeljet e rënda gjobiten me 300 mijë lekë.



NDËRPREJA E MARRËDHËNIES

Në të gjitha rastet kur konstatohet përsëritja e një ose disa prej shkeljeve të mësipërme, rishikohet ose ndërpritet kontrata e punës. Ndërsa në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje për punimet që janë paguar ose botimet që janë shpërblyer, Kolegji vendos kthimin e pagesës ose të shpërblymit pranë institucionit përkatës.

cilësisë së tyre. Për pasojë, vlerat shkencore dhe fuqia në titujve akademikë, madje edhe e diplomave "Bachelor" dhe "Master" të dhëna në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri janë të dobëta. Kodi synon të vendosë rregulla të forta në këtë proces, në formën e normave ligjore të detyrueshme për zbatim nga të gjitha institucionet arsimore e kërkimore si edhe nga të gjithë titujve kërkuesit, oponentët dhe udhëheqësit e kërkimit shkencor dhe të mbrojtjes së gradave e shkencore. Miratimi i Kodit pritet të sjellë rritjen e cilësisë, integritetit si edhe të dobisë praktike të veprimtarisë kërkimore dhe të gradave e titujve shkencorë në Shqipëri, në mbështetje të zhvillimit të vendit dhe të shkencës shqiptare.

sidomos dhënia e gradave shkencore dhe e titujve akademikë në Shqipëri ka nevojë

për një proces 'vetingu' dhe Kodi garanton zhvillimin e tij", thuhet në arsyetimin e

MAS. Po sipas këtij arsytimi, masivizimi i dhënies së gradave e titujve shkencore nuk

është shoqëruar nga krijimi i "filtrave" ligjorë, institucionale dhe moralë të garantimit të



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit" shpall:

- 1 (një) vend vakant për "Këshilltar Ligjor" me afat sa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,
- 1 (një) vend vakant për "Këshilltar Ligjor" me afat jo më pak se 6 (gjashtë) muaj dhe jo më shumë se 1 (një) vit.

KËRKESA TË POSAÇME:

- a) Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuar me ligj;
- b) Të ketë një përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose administratën publike jo më pak se 7 vjet;
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, si dhe për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, ose ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal;
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
- e) Të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 24 dhjetor 2018 deri më 10 janar 2019 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 janar 2019, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 24 dhjetor 2018 deri më 10 janar 2019 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuar me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.

Grëfhet marokenia: Bashkëpunimet e suksesshme, ja surprizat që kam për fansat

LAMAR AL-KOISMI:

Shqipëria më jep inspirim të bëj muzikë, repi më zgjodhi mua

"Është vështirë për të qëndruar në treg në sajë të talentit"

Egla Xhemali

Ajo është një vajzë 23-vjeçare nga Maroku, që ka pasur ëndërr të hyjë në botën e muzikës. Bija e një familjeje intelektuale, me të atin profesor matematike dhe të ëmën sekretare të Mbretit të Marokut, Lamar Al-Koismi ka kryer studimet e larta për Inxhinieri-Elektronike, megjithëse nuk e ka ushtruar si profesion, duke ndjekur rrugën drejt artit. Jeta e saj është mes Italisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë, ku jo pak herë është pjesë e mbrëmjeve të ndryshme festive. Me një bukuri orientale dhe zë tejet të veçantë, Lamar ka mundur të rrëmbëjë zemrat e të gjithëve. Bukuroshja ka arritur një numër ndjekësish të lartë në rrjetet sociale, si dhe ka audiencë të lartë në vendet ku performon. Pasi realizoi dy bashkëpunime të suksesshme, Al-Koismi vjen vetëm me një "artilieri të rëndë" në trendin më të fundit të muzikës, që ka përfshirë vajzat, rep. Lamar në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" na tregon për projektin e fundit, pse zgjodhi Shqipërinë për t'u afirmuar; bashkëpunimet, sa ka ndryshuar jeta e saj që kur ka famë, mungesën e familjes, si dhe planet për të ardhmen. "Next" titullohet kënga e saj, ku është edhe producente. Teksti i këngës është një mikses mes anglishtes dhe shqipës, që i jep ritëm të veçantë zërit të bukurshes. Me këtë produksion muzikor artistja do t'ju tregojë të gjithëve se si bëhet repi i mirëfilltë. Tashmë ajo vetëquhet "Queen of Rap".

Pse zgjodhe tregun muzikor në Shqipëri për t'u promovuar?

Pikësëpari, nuk ishte një zgjedhje, ishte e shkruar. Së dyti, Shqipëria është një nga vendet me muzikën më të mirë në Ballkan dhe unë jam e prirur të shkoj drejt më të mirës!

Cila është ajo gjë që të diferencion nga këngëtarët e tjerat?



Unë po bëj rep amerikan, jo rap të zakonshëm dhe nuk jemi e njëjta origjinë, nuk kemi të njëjtin stil. Janë shumë, shumë gjëra që më dallojnë.

Repi po preferohet masivisht nga femrat. Pse Lamari zgjodhi këtë rrymë?

Po, e vërtetë. Mua për shembull më pëlqen Niki Minazh, më pëlqejnë tekstet e saj. Nuk është se e zgjodha unë këtë rrymë, mund të them se kjo rrymë më zgjodhi mua, sepse unë flas për stilin e jetës, jetën e vështirë, gjërat që ndodhin, të mos kesh limite, pra të prekësh sa më shumë çështjet sociale, sepse kështu pëlqesh. Është e gjitha intuitë.

Çfarë të pëlqen më shumë nga Shqipëria?

Te Shqipëria më pëlqen natyra, sepse më jep inspirim të bëj muzikë si dhe fakti që kemi shumë gatime të ngjashme me vendin nga vij unë.

Sa ka ndryshuar jeta jote që nga momenti që i ke hyrë muzikës?

Nuk mund të them se

ndryshoi diçka, thjesht u bëra më shumë vetvetja, mu rrit më shumë vetëbesimi, vetëvlerësimi. Industria e muzikës është sa e bukur, aq edhe e vështirë për të qëndruar vetëm falë talentit. Ndonjëherë duhet të sakrifkoh shumë gjëra e madje të shesësh edhe veten, siç bëjnë shumë. Kështu që ose duhet të bësh si turma, ose të jesh e fortë dhe ndjekësh rrugën tënde, sipas mënyrës tënde dhe unë kam zgjedhur të dytën.

"Next" është kënga jote e fundit e publikuar disa ditë më parë. Kujt i kushtohet?

Nuk është se i kushtohet dikujt në veçanti. Jam treguar pak e ashpër në tekstin tim, sepse kënga është një 'diss' për ata që mundohen të më ulin poshtë, për ata që nuk duan që unë të bëj karrierën time, për të gjithë ata që duan të marrin nga unë dhe tentojnë të më pengojnë. Kështu që kush e gjen veten, i kushtohet. Është një 'diss' i përgjithshëm.

Cilat janë pritshmëritë e tua për projektin e fun-



dit?

Nuk është se unë pres gjithçka. Unë e kam arritur objektivin tim. Shumë shqiptarë e kanë dëgjuar dhe pëlqyer këngën time. Shumë njerëz më kanë shkruar, duke më uruar. Kjo më motivon, më shpyn mua të vazhdoj prapë, të tregoj se çfarë mund të bëj.

Sa e përdor frymën e 'diss'-eve?

Repi në vetvete është një diss, ndaj është e pran-



'diss'.

Bashkëpunimi me Fiffin ka rezultuar mjaft i suksesshëm. Do kesh bashkëpunime me artistë të tjerë?

Në fakt, pas këngës me Fiffin nuk kam pranuar asnjë bashkëpunim, pasi kënga me Fiffin mua nuk më solli asnjë përfitim si material, ashtu edhe moral. Pas disa këngësh, unë do të kem bashkëpunime me artistë ndërkombëtarë, ndoshta dhe shqiptarë, por njëherë dua të punoj vetëm, të tregoj stilin tim, çfarë mendoj, çfarë mund të bëj, të tregoj kapacitetin tim në muzikë dhe pastaj të bëj bashkëpunime.

Çfarë të mungon më shumë nga Maroku?

Unë jam marokene dhe jam krenare për origjinën time, e dua shumë Marokon. Por familja ime ndodhet në Europë, kështu që më mungon më tepër të shkoj dhe të takoj familjen.

Planet që ke për të ardhmen?

Kam shumë projekte, shumë këngë që dalin njëra pas tjetrës, ndërkohë unë po punoj dhe për albumin tim. Kështu që rrimi në pritje, gjëra të reja po vijnë!



Anxhela Martini ne Zvicër, çmend fansat me këmbët e saj

Modelja me origjinë shqiptare Anxhela Martini ka kaluar Krishtlindjet në Zvicër. Bukuroshja ka publikuar në rrjete sociale disa foto nga darka ku e shohim të veshur me një fustan ngjyrë ari. Ajo që bie në sy në këto foto janë këmbët e modeles, të cilat dalin mjaft në pah për shkak të këtij fustani mjaft të shkurtër. Prej disa kohësh ajo është lidhur në martesë me partnerin e saj rumun, Dragos Savulescu. Martini është një nga personazhet më 'IN' të momentit.



Fifi imiton në mënyrë fantastike Ronela Hajatin

Fifi dhe Ronela Hajati ishin dy prej këngëtareve të cilat së fundmi morën pjesë në spektaklin "Kenga Magjike 2018" dhe performancat e tyre u pritën mjaft mirë nga publiku. Këngët e tyre ishin ndër më të klikuarat në Youtube, duke u kthyer në hite të momentit. Së fundmi, në rrjet po qarkullon një video nga prapaskenat e "Këngës Magjike", ku Fifi imiton Ronelën teksa ajo performon në skenë. Këngëtarja imiton lëvizjet e Ronelës gjatë performancës së këngës "Vuj", duke kapur me duar fustanin njësoj si Ronela, teksa këndon plot emocion këngën e artistes. Përpos skenës buluroshet janë mike shumë të mira.



Noterë! Keni menduar për trashëgiminë tuaj

siç mendoni dhe për atë të klientëve tuaj?

Me Sigurimin Jetë me Mbijetesë keni përfitim dyfish: sigurim jete dhe investim afatgjatë. Mbroni pasardhësit tuaj në rast të të papiturave dhe njëkohësisht investoni me një normë të garantuar interesi prej 1.2% në vit, në monedhat Lek, Euro ose Dollar. Primi vjetor minimal duke filluar nga 200 euro/vit dhe shumë sigurimi deri në 120,000 euro!



Sigurim për Jetën



Sigurim nga Aksidentet



Sigurim nga Sëmundjet Kritike



SIGURIMI JETË me MBIJETESË

SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete

Për të blerë policën, kontaktoni me SiCRED në: **Tel:** +355 4 22 37 549 | **Cel:** +355 69 20 84 026 | **e-mail:** shitje@sicred.com.al

Në total janë rreth 1.6 milionë individë që jetojnë jashtë territorit të vendit

EUROSTAT: 330 mijë shqiptarë fituan nënshtetësi në vendet e BE-së në 16 vite

Greqia dhe Italia janë dy vendet që kanë dhënë numrin më të lartë të nënshtetësive për emigrantët shqiptarë

TIRANË

Që prej vitit 2002, rreth 330 mijë shqiptarë që jetojnë jashtë kanë marrë nënshtetësinë e një vendi anëtar të Bashkimit Evropian. Greqia dhe Italia janë dy vendet që kanë dhënë numrin më të lartë të nënshtetësive për emigrantët shqiptarë.

Prej 2002, rreth 150 mijë shqiptarë kanë marrë nënshtetësinë greke dhe rreth 148 mijë kanë marrë nënshtetësinë italiane. Komuniteti shqiptar është i dyti në Itali për sa i përket numrit.

Të dhënat e publikuara nga EUROSTAT dhe të përpunuara nga "Monitor" tregojnë se në 2017-ën, në Itali kishte rreth 448 mijë shqiptarë, ndërsa të dhënat për numrin e shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë Greqi nuk janë të raportuara.

Vendi i tretë për sa i përket lëshimit të nënshtetësive është Mbretëria e Bashkuar, ku prej 2002 janë dhënë rreth 11 mijë të tilla. Nënshtetësinë gjermane e kanë marrë 5700 shqiptarë. Të dhëna nga EUROSTAT tregojnë se në vitin 2017, numri i shqiptarëve që jetojnë atje u përgjysmua nga 74 mijë në 49 mijë. Pjesa më e madhe e tyre kanë qenë azilkërkues, të cilët iu është refuzuar kërkesa për azil dhe janë riatdhesuar në Shqipëri. Nga 2011, në Gjermani kanë aplikuar për azil në Gjermani 90 mijë shqiptarë, por pjesa më e madhe e tyre kanë marrë përgjigje negative. Më pas në numrin e nënshtetësive të lëshuara ishte Belgjika me 5000 aplikime.

Franca lëshoi rreth 3400 nënshtetësi për këtë periudhë. Mungojnë të dhënat e raportuara nga Franca mbi numrin e shqiptarëve që jetojnë aktualisht atje, por së fundmi ka pasur një bum të kërkesave për azil nga shqiptarët, duke u renditur në 3 vendet kryesore të origjinës. Prej 2011-ës rreth 40 mijë shqiptarë kanë aplikuar për azil në Francë. Në Suedi dhe në Austri janë lëshuar respektivisht nga 1000 nënshtetësi për shtetas shqiptarë. Në total janë rreth 1.6 milionë individë që jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë, sipas të dhënave të diasporës, një publikim i ri i INSTAT. Nga këta, 825 mijë individë (gati 53%) janë meshkuj dhe 755.6 mijë janë femra/ Monitor/.

ITALI/ANGLI

Komuniteti shqiptar është i dyti në Itali për sa i përket numrit të emigrantëve. Të dhënat e publikuara nga EUROSTAT dhe të përpunuara nga "Monitor" tregojnë se 2017-ën, në Itali kishte rreth 448 mijë shqiptarë, ndërsa të dhënat për numrin e shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë Greqi nuk janë të raportuara. Vendi i tretë për sa i përket lëshimit të nënshtetësive është Mbretëria e Bashkuar, ku prej 2002-sht janë dhënë rreth 11 mijë të tilla.



Foto Ilustruese

GJERMANI

Nënshtetësinë gjermane e kanë marrë 5700 shqiptarë. Të dhëna nga EUROSTAT tregojnë se në vitin 2017, numri i shqiptarëve që jetojnë atje u përgjysmua nga 74 mijë, në 49 mijë. Pjesa më e madhe e tyre kanë qenë azilkërkues, të cilët iu është refuzuar kërkesa për azil dhe janë riatdhesuar në Shqipëri. Nga 2011, në Gjermani kanë aplikuar për azil në Gjermani 90 mijë shqiptarë, por pjesa më e madhe e tyre kanë marrë përgjigje negative.

Nisma, mbështetje nga KPÇSSH dhe nga deputetë

Në 3 vite mbi 20 mjekë të arrestuar, bluzat e bardha: Të dekriminalizohet gabimi mjekësor



TIRANË - Në tri vitet e fundit numërohen mbi 20 mjekë të arrestuar për shkak të gabimeve mjekësore në ushtrimin e detyrës. Sipas TV "Klan", bluzat e bardha kërkojnë të dekriminalizohet gabimi mjekësor në këtë profesion, duke e kthyer nga çështje penale në administrative, por duke bërë dallim nga neglizhenca. "Duhet të dekriminalizohet gabimi njerëzor dhe të kthehet në çështje administrative, sepse nuk bëhet me dashje dhe është e gabuar të shkohet në burg apo në gjykimin penal të çështjes. Nuk po flasim kur nuk jep ndihmën mjekësore, se kjo është çështje penale, por po flasim gjatë punës që ndodhë gabim njerëzor, çështje teknike, apo të diagnozës", thotë kirurgu Arben Gjata. Kjo nismë e bluzave të bardha ka gjetur mbështetje edhe nga anëtarët e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. "Patjetër që po, do e merrja në gjykim, parimisht jam dakord, por duhet parë konkretisht. E kam ndërje këtë nevojë që legjislati shqiptar të ndryshojë në këtë pikë. Nuk duhet të konsiderohet çdo gabim mjekësor veç për penale, për ti dhënë edhe kompetencën dhe besimin e mjekut gjatë ushtrimit të profesionit dhe për të luftuar mjekësinë difensive", shprehet deputetja e PS-së, Edlira Bode.

"Jam dakord me një iniciativë të tillë të bluzave të bardha, një çështje e tillë demotivon mjekun, dhe mjekun përballë pacientit nuk e mban as përgjegjësi penale, asgjë tjetër, por e mban misioni humanitar që ka përballë një akti të tillë. Ne nuk kërkojmë që mjeku të mos ndëshkohet, por të rishikohen hapat dhe së pari është Urdhri i Mjekut që rishikon mjekun", deklaroi deputetja demokratike, Orjola Pampuri. Sipas nenit 96 të Kodit Penal Shqiptar, mjekimi i pakujdesshëm dënohet me gjobë deri në 5 vjet heqje lirie.

DEPUTETJA E PS-SË

"Patjetër që po, do e merrja në gjykim, parimisht jam dakord, por duhet parë konkretisht. E kam ndërje këtë nevojë që legjislati shqiptar të ndryshojë në këtë pikë. Nuk duhet të konsiderohet çdo gabim mjekësor veç për penale, për ti dhënë edhe kompetencën dhe besimin e mjekut gjatë ushtrimit të profesionit dhe për të luftuar mjekësinë difensive", shprehet deputetja e PS-së, Edlira Bode.

DEPUTETJA E PD-SË

"Jam dakord me një iniciativë të tillë të bluzave të bardha, një çështje e tillë demotivon mjekun, dhe mjekun përballë pacientit nuk e mban as përgjegjësi penale, asgjë tjetër, por e mban misioni humanitar që ka përballë një akti të tillë. Ne nuk kërkojmë që mjeku të mos ndëshkohet, por të rishikohen hapat dhe së pari është Urdhri i Mjekut që rishikon mjekun", deklaroi deputetja demokratike, Orjola Pampuri.

Plan masash për festat e fundvitit,

kontrolle në pika kyçe

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka hartuar një plan masash, duke përcaktuar objektiva të qarta për të siguruar mbarëvajtjen e ditëve festive dhe krijimin e një mjedisit të sigurt për qytetarët. Në këtë plan masash janë përcaktuar objektivat dhe detyrimet për strukturat e policisë nëpërmjet të cilave synohet: Rritja e sigurisë së komunitetit; parandalimi i ngjarjeve kriminale, nëpërmjet kontrollit të plotë nga strukturat e policisë; sigurimi në kohë i informacioneve për parandalimin e ngjarjeve kriminale, planifikimi dhe zbatimi i masave për kapjen e autorëve të mundshëm dhe vënien e tyre para përgjegjësisë ligjore. Rritjen e prezencës policore në akset kryesore rrugore, në funksion të parandalimit të aksidenteve rrugore dhe ngjarjeve kriminale si dhe forcimi i masave për kontrollin ndaj subjekteve që tregtojnë fishkekzjarrë, duke bashkëpunuar me strukturat e tjera ligjzbatuese. Strukturat e policisë kanë planifikuar masa për mbajtjen në kontroll të situatës së sigurisë, në veçanti në sheshet publike, qendra tregtare që frekuentohen nga numër i madh qytetarësh, lokale dhe restorante, apo sheshe ku do të organizohen aktivitete festive etj.

Shqipëria 60 vjet në organizatë, sfidat 12-vjeçare

Pranimi i Shqipërisë në UNESCO, ja letërkëmbimet sekrete

"Mbretëria e Bashkuar është kundër aplikimit shqiptar"

Nga Bejtullah Destani
& Kastriot Frashëri

Këtë vit Shqipëria kujton me krenari 60-vjetorin e pranimit të saj në UNESCO. Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) për shkak të rrethanave të krijuara në disfavor të saj zgjati mbi 12 vjet, po t'i referohemi dokumentacionit të kohës, që ka zanafillën që nga data e shprehjes zyrtarisht të kërkesës së qeverisë sonë në muajin nëntor të vitit 1946-të.

Dihet se UNESCO është një organizatë e specializuar e OKB-së, në fushën e arsimit, kulturës dhe shkencës, e themeluar vetëm pak muaj pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, më 16 nëntor 1945. Për të siguruar anëtarësinë në këtë organizatë ndërkombëtare të rëndësishme të kohës, vendit tonë iu desh një punë diplomatike e vazhdueshme, që nga viti 1946, kur paraqiti kërkesën e parë dhe vetëm pas pranimi si anëtare e OKB-së, në dhjetor 1955, atëherë procedura e pranimit në Shqipërisë në UNESCO duket se u bë më e thjeshtë.

Aplikimet e paraqitura nga shtetet joanëtare të Kombeve të Bashkuara për t'u pranuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, bazuar në nenin 2, paragrafi II të Statutit të UNESCO-s, do të transmetoheshin menjëherë nga Sekretariati i Përgjithshëm i kësaj organizate në Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara, i cili ishte organi kompetent që rekomandonte pranimin ose refuzimin e kërkesës. Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë nuk që i lehtë për vendim tonë, pasi Mbretëria e Bashkuar ishte kundër aplikimit shqiptar, pasi Shqipëria, sipas saj, ishte i vetmi vend që kishte injoruar në mënyrë flagrante vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (Rasti i Kanalit të Korfuzit).

Referuar burimeve arkivore që disponojmë, pavarësisht se vendi ynë Shqipëria miratoi Konventën Themeluese të organizatës, duke i hapur rrugën firmosjes së Konventës, e cila u bë nga përfaqësuesi i Shqipërisë në Paris. Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, në bazë të politikave të saj të paqes dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, ka vendosur të kërkojë pranimin e Republikës Popullore të Shqipërisë si anëtare të UNESCO. Duke dorëzuar këtë aplikim, nga Parisi më 6 tetor 1954, në përputhje

me nenin 92 të rregullave procedurale të Konferencës së Përgjithshme, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë i kërkoj drejtorit të përgjithshëm të kryejë veprimet e duhura, me qëllim që të vendoset në axhendën e seksionit të ardhshëm të Konferencës së Përgjithshme, e cila do të mbahet në Montevideo më 12 nëntor 1954. Në të njëjtën ditë u dorëzua edhe instrumenti i miratimit të Konventës së 16 nëntorit 1945, te drejtori i përgjithshëm i UNESCO-s dhe kësaj, Shqipëria u bë anëtare e saj më 16 tetor 1958. Sigurisht në këto përpjekje Shqipëria gjeti edhe miq e dashamirës të saj, të cilët e ndihmuan atë për t'i hapur rrugë progresit dhe përparimit të saj. Një prej tyre ishte edhe z. Luther H. Evans, drejtor i përgjithshëm i UNESCO-s, i cili e mbështeti fort kërkesën e vendit tonë përpara organizmave të Kombeve të Bashkuara.

Anëtarësimi i vendit tonë në organizatën më të madhe të Kombeve të Bashkuara më 16 tetor 1958, duket se e ndihmoi Shqipërinë e atëherëshme të luftonte analfabetizmin e trashëguar ndër shekuj rrobëri në përpjekje për të nxjerrë vendin nga një prapambetje e theksuar ekonomike dhe shoqërore.

Kështu nisi edhe bashkëpunimi ynë tashmë 60-vjeçar i Shqipërisë me këtë organizatë, me dritëhijet e veta, dhe sot ne jemi bërë palë e të gjitha konventave dhe politikave transformuese të UNESCO-s.

Më poshtë po i paraqesim lexuesit për mundësi gjykimi letërkëmbimet e kohës rreth kësaj çështjeje në katër dokumente, të cilat botohen për herë të parë.

Kombet e Bashkuara Këshilli Ekonomik dhe Social

Aplikim nga Republika Popullore e Shqipërisë për anëtarësim në UNESCO

Në përputhje me nenin II të marrëveshjes ndërmjet Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara ka marrë nga Drejtori i



Sella e UNESCO-s

Përgjithshëm i UNESCO një letër që e informon atë se Republika Popullore e Shqipërisë ka paraqitur një kërkesë për t'u bërë anëtare e Organizatës.

Bashkëngjitur po ju dërgohet letra e Drejtorit të Përgjithshëm dhe aplikimi i Republikës Popullore të Shqipërisë që e shoqëron atë.

Deklarata e urgjencës e përmendur në letër përmban të dhënat e mëposhtme:

"Neni II i Marrëveshjes ndërmjet Kombeve të Bashkuara dhe UNESCO-s, vijon si më poshtë:

"Pranimi i shteteve joanëtare të Kombeve të Bashkuara

Aplikimet e paraqitura nga shtetet joanëtare të Kombeve të Bashkuara për t'u pranuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën do të transmetohen menjëherë nga Sekretariati i Organizatës në Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara... Këshilli mund të rekomandojë refuzimin e kërkesave të tilla dhe çdo rekomandim i tillë do të pranohet nga Organizata. Nëse, brenda gjashtë muajve nga marrja e një kërkesë nga Këshilli, nuk është bërë një rekomandim i tillë, kërkesa do të trajtohet në përputhje me nenin II, paragrafi 2 të Statutit të Organizatës".

TELEGRAM

Nga Zyra e Marrëdhënieve të Komunikimit

11 nëntor, 1954

KONFIDENCIALE

Adresuar: Komisionerëve të Lartë të MB në Kan-

bera Nr. 1019 dhe Karaçi Nr. 1536, për Delegacionin e MB në Nju Jork, Delegacionin të Gjeneralit, Washington dhe Montevideo.

Aplikimi i Shqipërisë për pranimin në Organizatën Arsimore Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara

Kjo kërkesë do të shqyrtohet nga Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara më 19 nëntor.

2. Një aplikim i ngjashëm nga Bullgaria u miratua nga Këshilli më 5 nëntor dhe jetë vota kundrejt gjashtë dhe me dy abstencione, duke përfshirë Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA. Përfaqësues të Australisë dhe të Pakistanit mbështetën dhe gjithashtu folën në favor, edhe pse me pak entuziazëm duke e bazuar mbështetjen e tyre në parimin e universalitetit të anëtarësimit në Kombet e Bashkuara dhe të organizatave të specializuara.

3. Mbretëria e Bashkuar është kundër aplikimit shqiptar, pasi Shqipëria është i vetmi vend që ka injoruar në mënyrë flagrante vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (Rasti i Kanalit të Korfuzit).

4. Delegacioni i Mbretërisë së Bashkuar ka shprehur kundërshtimin e Mbretërisë së Bashkuar ndaj përfaqësuesve të Australisë dhe Pakistanit, të cilët shprehën keqardhje dhe thanë se do të toleronin qeveritë e tyre, duke u kërkuar refuzimin e aplikacioneve. Këndvështrimet përfaqësuesve të Mbretërisë së Bashkuar sipërcaktohen në paragrafin

2, urgjent për autoritetet australiane /pakistaneze dhe shprehin shpresën se përfaqësuesit e tyre duhet të udhëzohen për të kundërshtuar aplikimin shqiptar.

Artikulli II, paragrafi 2 i statutit të UNESCO

Në bazë të kushteve të Marrëveshjes ndërmjet kësaj Organizate dhe Organizatës të Kombeve të Bashkuara mund të pranohen për anëtarësim në Organizatë, me rekomandim të Bordit Ekzekutiv, me dy të tretat e votave të Konferencës së Përgjithshme.

Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s do ta mbajë seancën e saj të tetë nga 12 nëntori deri më 11 dhjetor 1954. Ajo nuk do të mbledhet me deri në vitin 1956. Bordi Ekzekutiv i UNESCO-s, do të mbahet disa ditë para sesionit të tetë të Konferencës së Përgjithshme.

Prandaj, shqyrtimi nga Këshilli Ekonomik dhe Social në seancën e saj të parë të aplikimit të Republikës Popullore të Shqipërisë është e nevojshme për të mundësuar që Konferenca e Përgjithshme e UNESCO të marrë në shqyrtim këtë çështje në sesionin e saj të ardhshëm.

Letër nga Legata në Francë e Republikës Popullore të Shqipërisë, drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO

Paris 6 tetor 1954

Kam nderin t'ju informoj se jam i autorizuar nga qeveria ime për t'ju komunikuar për sa në vijim:

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, në bazë të politikave të saj të paqes dhe bashkëpunimit

ndërkombëtar, ka vendosur të kërkojë pranimin e Republikës Popullore të Shqipërisë si anëtare të UNESCO.

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, deklaroi gatishmërinë e saj për të vepruar në përputhje me Statutin e Organizatës, të pranohet detyrimet që kjo sjell, si dhe të marrë pjesë në shpenzimet e Organizatës.

Duke dorëzuar këtë aplikim, në përputhje me rregullin (nenin) 92 të rregullave procedurale të Konferencës së Përgjithshme, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë i kërkon Drejtorit të Përgjithshëm të kryejë veprimet e duhura, me qëllim që të vendoset në axhendën e seksionit të ardhshëm të Konferencës së Përgjithshme, e cila do të mbahet në Montevideo më 12 nëntor 1954.

Shemsi Totozani
Ministër

LETËR NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM I ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ARSIMIN, SHKENCËN DHE KULTURËN PËR SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM

Paris, 12 tetor 1954

Kam nderin t'ju informoj se kam marrë një kërkesë në datën 6 tetor 1954 nga Republika Popullore e Shqipërisë për anëtarësim në UNESCO.

Po bashkëlidh një kopje të kësaj kërkesë dhe unë do të jem mirënjohës nëse do të më bënit të mundur që ajo të shtrohet përpara Këshillit Ekonomik dhe Social në sesionin e tij të 17-të, të rifilluar për shqyrtim urgjent. Bashkëlidhur ju dërgoj edhe një deklaratë në mbështetje të kërkesës sime.

Prandaj duhet ta vlerësoj shumë atë, nëse Këshilli Ekonomik dhe Social, duke vepruar sipas nenit 17 të rregullorës së tij të procedurës do të konsideronte mundësinë e shtimit të kësaj pike në axhendën e tij dhe të marrjes së tij gjatë rifillimit të seancës së saj.

Luther H. Evans
Drejtor i Përgjithshëm

Dokumentet që publikohen me këtë rast janë marrë nga: "The National Archives", London, UK.

DEBATI

MBYLLJA E 'ONUFRIT'

Eleni Laperi: E vendosi ministria, në 2019 do ketë ekspozitë tjetër

Fatmira Nikolli

Si lindi 'Onufri' 20 vite më parë, udhëtimi e ngecja e tij dhe sharmi i humbur i G.K.A

"Fatkeqësisht C.O.D. u kthye në një konkurrent të G.K.A., duke i marrë fonde, publik, aktivitete"

Mbyllja e konkursit "Onufri" që mbahej prej 20 vitesh në Galerinë Kombëtare të Arteve u njoftua zyrtarisht vetëm drekën e 24 dhjetorit, kohë kur ekspozita duhej të ishte në një nga sallat e G.K.A. Prej një muaji, debati për të në rrethet artistike kishte nisur, por kishte rënë në veshin e shurdhër të Ministrisë së Kulturës dhe Galerisë Kombëtare të Arteve. Ndërsa artistët kundërshtonin mbylljen e tij, institucionet zyrtare heshtnin. Njoftimi i shpërndarë mediave më 24 dhjetor, shprehej se vendimi ishte marrë në mesin e nëntorit nga mbledhja e bordit të G.K.A. Megjithatë, rregullorja e "Onufrit", që ende gjendet në faqen zyrtare të Galerisë, parashikon që për konkursin, puna nis në prill, kur hapet thirrja për kurator i cili pasi zgjidhet përcakton konceptin e tij, temën dhe nis përzgjedhjen e artistëve. Paqka se njoftimi shkruan se vendimi u mor nga bordi në nëntor, de facto, "Onufri" është mbyllur që në prill - dhe nëse në këtë vendim është i përfshirë bordi, është e paqartë.

Eleni Laperi, studiuese e artit pamor, ish-punonjëse e G.K.A.-së dhe kryetare e Bordit aktual, në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" tregon se si lindi "Onufri", çfarë synohej me të, dhe çfarë nuk e arriti dot, si ishte Galeria në atë kohë, pse "është zhbërë" tani, kush e mori vendimin për mbylljen e ekspozitës - konkursi ndërkombëtar, si e sheh ajo drejtorin Erzen Shkololli dhe çfarë do të ndodhë në vitin 2019.

"Me ndërrimin e drejtorëve, revista nuk u botua më, 'Marubi' dhe Bienenja nuk u organizuan më, dyqani dhe bar-kafeja u mbyllën, programi i edukimit u kthye më shumë në kurs vizatimi për fëmijë. Në përgjithësi drejtorët e G.K.A. kanë qenë zgjedhur vetëm se militonin në partinë, që merrte pushtetin", thotë Eleni Laperi, që prej kohës ka një blog të sajën ku publikon studime a komente mbi çështje të artit pamor.

Më poshtë, intervista e saj.

"Onufri" u mbyll. A është e përkohshme kjo mbyllje?

Mbyllja përfundimisht e konkursit "Onufri" u vendos nga Ministria e Kulturës, e cila kërkoi edhe mendimin e Galerisë



Eleni Laperi

Kombëtare të Arteve, si institucioni i ngarkuar për ta zhvilluar këtë aktivitet.

-Znj.Laperi, si një prej atyre njerëzve që e kanë ndjekur G.K.A.-në nga afër e larg prej vitesh, çfarë ishte 'Onufri' për ju dhe për skenën e artit?

Unë kam punuar disa vite në sektorin e studimit të Galerisë Kombëtare të Arteve. Ishin vite kur të gjithë punonin duke imituar idhuj, që i kishin adhuruar fshehurazi për një kohë të gjatë; kur të gjithë nisën të ekspozonin çdo gjë pa kurrfarë përzgjedhjeje, duke shprehur çlirimin nga kontrolli i ashpër i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe komitetëve të partisë. Ishte koha kur nisën të krijohen shoqatat e pavarura të artistëve, koha kur nëse nuk e pranoje dikë në shoqatën e krijuar prej teje, dëgjoje komente nga më denigrueset. Ishte koha kur të gjithë krahasonin krijimtarinë me vetveten, duke mos e kuptuar se kishte ardhur koha kur krahasimi do bëhej me krijimtarinë botërore. Ishte koha kur vetëm lavdëronim njeri-tjetrin, pasi kritika shihej si mbeturinë e së kaluarës, e kohës kur të kritikonin vetëm nëse devijojë nga direktivat e partisë.

Në vitin 1997 u vendos të organizohej konkursi kombëtar 'Onufri', i cili mendoj se u pa më shumë si një ekspozitë, që duhej të zëvendësonte vendin e lënë bosh nga ekspozita e madhe, që diktatura organizonte çdo nëntor, për të pasqyruar nëpërmjet artit sukseset në ekonomi e poli-

EKSPOZITA E RE

Në vend të konkursit "Onufri", G.K.A. do të organizojë në vitin 2019 një ekspozitë ndërkombëtare, e cila do të jetë e përvitshme. Ndryshe nga "Onufri", nuk do të jetë konkurs dhe kuratori/kuratorët, shqiptarë apo të huaj, do të përzgjidhen nga hulumtimet e vetë galerisë, punë e cila ka filluar. Do jenë ata që do të zgjedhin artistët pjesëmarrës në ekspozitë, duke bërë të mundur edhe njohjen e mirë të arritjeve të artistëve shqiptarë në një proces ballafaqimi me prijjet bashkëkohore ndërkombëtare.

tikë. Ishte, pra, e konceptuar pak a shumë si ekspozitë e mëparshme, përveç emrit - emri i një ikonografi mesjetar i cili nuk kishte të bënte aspak me lojin e artit që ajo do prezantonte. Por edhe emri shprehte çlirimin nga tabuja e dikurshme e vlerësimit të artit kishtar. Më pas konkursi "Onufri" u kthye në ekspozitë ndërkombëtare.

-Deklarata e G.K.A.-së thotë se disa edicione të "Onufrit" nuk kanë pasur nivelin e duhur të organizimit për t'i prezantuar denjësisht artistët. Më konkretisht, për se flitet?

Ky mendim ka qenë edhe i disa artistëve apo personazheve të artit pamor shqiptar në vite. Një tjetër fakt është se asnjëherë nuk u respektua statusi i konkursit "Onufri" për të prezantuar arritjet e një viti në artin tonë pamor. Konkursi herë u organizua si ekspozitë lokale, herë si ekspozitë ndërkombëtare, herë si aktivitet miks, sipas dëshirës së drejtorëve të G.K.A. Edhe pse vijoi të organizohet për dy dhjetëvjeçarë, konkursi "Onufri" nuk arriti të tërheqë vëmendjen e skenës artistike botërore, nuk arriti të promovojë në botë artistë shqiptarë, nuk i justifikoi fondet dhe rolin e tij si një aktivitet i integritimit dhe promovimit

të artit pamor shqiptar në skenën botërore.

- Bashkëveprimi midis artistëve shqiptarë dhe të huaj në kuadër të këtyre edicioneve ka qenë pothuajse fiktiv, pasi shumë nga artistët e huaj pjesëmarrës të "Onufrit" nuk kanë ardhur. Sa e rëndësishme është kjo për të mbajtur në këmbë "Onufri"?


Nuk ka qenë gjithnjë ashtu. Artistë të huaj kanë ardhur madje ndonjëherë të gjithë. A ka pasur bashkëveprim me artistët shqiptarë? Nuk mbaj mend të ketë pasur bashkëbisedime të organizuara në kuadrin e "Onufrit", po mendoj se askush nuk i ka ndaluar artistët shqiptarë të bashkëbisedojnë me artistët e huaj. Veç ne kemi ende një problem, që ndoshta lidhet me tiparin të cilin e mburrim shumë, me krenarinë: e kemi të vështirë të ulemi të dëgjojmë tjetrin të na flasë për krijimtarinë e tij. Edhe kur galeria ka organizuar biseda me autorët, ka pasur nga ata që kanë ardhur më shumë për të zbratur ndonjë pakënaqësi se sa të dëgjojnë, të pyesin e të mësojnë dicka nga autori.

- Artistët shqiptarë kalonin fazën e përzgjedhjes të huaj ftoheshin nga kuratori. A ka ndodhur shpesh kjo znj.Laperi?

Ka pasur raste kur kuratorët ishin të detyruar t'i ftonin artistët e huaj. Nuk mund të pretendojë që Marina Abramoviç, etj. të vinin të konkurronin me artistë, që ende ishin të panjohur për skenën botërore. Një prej arsyeve që goi në kthimin e konkursit "Onufri" në ekspozitë ndërkombëtare ishte sjellja në Shqipëri e tendencave më të mira bashkëkohore ndërkombëtare, krijimi i kontakteve me kuratorë e institucionet e huaja të artit pamor, që do ndihmonin integritimin e artit shqiptar në artin botëror.

-Kur thuhet se G.K.A ka nevojë për një formatim dhe një qasje të re pune, çfarë nënkuptohet?

Nënkuptohet vijimi i punës nisur vite më parë. Unë jam larguar nga G.K.A. në mesin e vitit 2000. Në atë kohë galeria organizonte tri aktivitete ndërkombëtare, që ndihmonin njeri-tjetrin: konkursin "Onufri", Bienenalën e Tiranës dhe konkursin "Marubi". Galeria botonte një revistë, revistën "PamorArt"; zhvil-



lonte një program edukimi nëpërmjet artit, aq i domosdoshëm për edukimin demokratik të shqiptarëve, sidomos të brezit të ri. U ngrit një bibliotekë dhe u sigurua një koleksion me vepra të artistëve bashkëkohorë, falë Jan Dibets, një personaliteti të arteve pamore botërore; veprat e koleksionit nisën t'i prezantohen publikut si në gjithë muzetë evropiane në bazë të një koncepti kuratorial, duke i dhënë mundësi galerisë të ekspozonte një pjesë të madhe të koleksionit të saj; u hap një dyqan suvenirësh dhe një bar-kafe si në gjithë galeritë e muzetë e botës. Stafit që shërbente në reception dhe në salla ishte i trajnuar të mirëpriste vizitorët shqiptarë dhe të huaj. Madje kishte edhe një rrap-ncj-dravjeçar, që zburonte oborrin e galerisë, si një simbol i Tiranës së vjetër. Pra ishte një galeri kombëtare në udhën e shndërrimit në një institucion evropian.

Me ndërrimin e drejtorëve, revista nuk u botua më, 'Marubi' dhe Bienalja nuk u organizuan më, dyqani dhe bar-kafeja u mbyllën, programi i edukimit u kthye më shumë në kurs vizatimi për fëmijë. Në përgjithësi drejtorët e G.K.A. kanë qenë zgjedhur vetëm se militonin në partinë, që merrte pushtetin. Ata ose nuk kishin ide dhe fantazi të drejtonin një institucion të tillë, ose nuk kishin lidhjet e duhura me personazhe dhe institucione ndërkombëtare të artit që të vijonin punën e nisur, ose nuk donin të punonin dhe punonin për vete. Drejtorët e galerisë kanë lejuar të piqen qoftë pas ikonostasit në katin e dytë, mbanin në zyrë thes me arra, pula e gjela, që i therrnin në oborrin e pasëm të galerisë, botonin katalogë ku promovonin bashkë me punët e koleksionit të galerisë edhe koleksionin e tyre personal dhe drejtorit pasardhës i linin zyrën vetëm me katër muret. Kur punon në galeri arti, mëson se sa ndryshe është të shohësh galerinë me sytë e vizitorit dhe sa ndryshe është pasi të njohësh mënyrën si funksionon ajo, sepse mëson

se interesat e artistëve janë të ndryshme nga interesat e administratorëve të institucionit. Ndërsa të parët janë të interesuar të ekspozojnë kur duan dhe si duan, apo që galeria të blejë sa më shtrënjtë punët e tyre, administratorët janë të interesuar të përzgjedhin ekspozitat dhe të shpenzojnë sa më pak për pasurimin e fondit- gjë që është praktikë ndërkombëtare. Ndoshta artistët shqiptarë duhej të ishin të parët të interesuar që G.K.A. të jetë një institucion elitar, me kritere të rrepta përzgjedhjeje, ku të ekspozohen arritjet më të mira, ku artisti ta ketë për nder të pranohet të ekspozojë, ku t'i ofrohet mundësi të njihet në skenën botërore të artit.

Një mundësi për një qasje të re pune mendoj se do ta sjellë drejtori i tanishëm i GKA, Erzen Shkololli. Për herë të parë në këta 28 vjet galeria drejtohet nga një profesionist me eksperiencë në drejtimin e një institucioni si G.K.A., pasi ka drejtuar për disa vjet Galerinë Kombëtare të Kos-

Me ndërrimin e drejtorëve, revista nuk u botua më, 'Marubi' dhe Bienalja nuk u organizuan më, dyqani dhe bar-kafeja u mbyllën, programi i edukimit u kthye më shumë në kurs vizatimi për fëmijë...

ovës. Shkololli ka një përgatitje të mirë në fushën e arteve pamore, ka eksperiencë ndërko-

mbëtare si kurator dhe synon ta vërë këtë eksperiencë në shërbim të barazimit të aktivitetit të G.K.A. me aktivitetet e institucioneve më të mira të artit pamor jashtë vendit.

-Ka pasur shumë reagime pas këtij vendimi, qoftë edhe frikë se një konkurs/ekspozitë ndërkombëtare u mbyll. Çfarë na bën të mendojmë se 'Onufri' nuk do ketë fatin e çmimit për fotografinë që jepte dikur GKA?

Në vend të konkursit 'Onufri' G.K.A. do të organizojë në vitin 2019 një ekspozitë ndërkombëtare, e cila do të jetë e përvitshme. Ndryshe nga 'Onufri', nuk do të jetë konkursi dhe kuratori/kuratorët, shqiptarë apo të huaj, do të përzgjedhin nga hulumtimet e vetë galerisë, punë e cila ka filluar. Do jenë ata që do të zgjedhin artistët pjesëmarrës në ekspozitë, duke bërë të mundur edhe njohjen e mirë të arritjeve të artistëve shqiptarë në një proces ballafaqimi me prirjet bashkëkohore ndërkombëtare. Shpesh harrojmë se pluralizmi nuk është vetëm politik, pluralizmi është edhe kulturor. Pranuam me kënaqësi t'i drejtohem të tjerëve me titujt: shkëlqesi, zonjë, zotni, po nuk po pranojmë ende se Galeria Kombëtare e Arteve është e duhet respektuar si 'Zonja e parë' e galerive shqiptare. Nuk mund të vijojmë të pretendojmë se të gjithë mund të ekspozojnë atje si dikur. Ndonëse me ritëm të ngadaltë, ky mentalitet po ndryshon. Po krijohen grupime, të cilët përfaqësojnë shijet e ndryshme të publikut, interesat, nivelin dhe prirje të për-bashkëta të krijuesve, si: grupi Nëntori, grupi i peizazhistëve, grupi i akuarelistëve, grupimi i Pranverës, etj. Janë krijuar institucione si galeria e Universitetit të Arteve, galeria 'Zeta', 'Zeni', 'Bazzament', 'Kalo', etj., apo qendra si Tirana 'ArtLab', 'Harabel', 'Tulla'. Secili ka të drejtë të përzgjedhë artistë që i përshtaten grupit dhe të refuzojë ata që nuk i përshtaten. A janë të gjitha të një niveli të mirë, profesional? Edhe në Nju Jork ka mbi 6000 galeri, po kuratorët e Muzeut të Artit Modern të sugjerojnë të vizitosh vetëm një numër të vogël prej tyre. Ak-

ISH-DREJTORËT E G.K.A.

Drejtorët e galerisë kanë lejuar të piqen qoftë pas ikonostasit në katin e dytë, mbanin në zyrë thes me arra, pula e gjela, që i therrnin në oborrin e pasëm të galerisë, botonin katalogë ku promovonin bashkë me punët e koleksionit të galerisë edhe koleksionin e tyre personal dhe drejtorit pasardhës i linin zyrën vetëm me katër muret.

tivitetet ndërkombëtare duhet të jenë synim edhe i nismave private. Shembujt nuk mungojnë: është 'Art House' në Shkodër, nismë e Adrian Pacit, ku vijjnë artistë e teoricienë të artit shqiptar e të huaj dhe po e kthejnë qytetin në një destinacion kulturor; janë gjithashtu F.A.B., Andi Tepelena, Driant Zeneli, Adela Demetja, Helidon Haliti, Rubin Beqo, Genti Korini, etj. në Tiranë, që organizojnë aktivitetet me prurje vendase e të huaja. A është e vështirë? Është shumë e vështirë. Po askund, askush nuk të jep gjë po nuk u lodhe, po nuk u përpoqe, po nuk dite e po nuk pate prirjen e duhur. Megjithatë, unë mendoj se pluralizmi kulturor të ne duhet mbështetur edhe me ligj, duhen nxitur e financuar nga shteti aktivitetet, që i rezistojnë kohës dhe kanë pretendime serioze nga ana e organizatorëve.

Pse patët bindjen se duhej mbyllur për të pritur rikonceptimin?

Kjo nuk ishte bindja ime, pasi nuk e mora unë këtë vendim.

-Sa mund të zgjasë faza e formatimit?

Ndoshta formatimi duhet të nisë nga një tjetër plan, nga një tjetër këndvështrim: drejtorët e Galerisë Kombëtare të Arteve nuk duhet të jenë zgjedhje politike, pasi GKA nuk është as e të majtëve, as e të djathtëve. Galeria Kombëtare e Arteve është institucion në shërbim të kulturës pamore shqiptare dhe jo të partive politike. Ndërsa drejtorët ndërrohen kur ndërrohen pushtetet, shpesh pa arritur të kuptojnë cila ishte detyra e tyre, ndërkohë që në Francë p.sh. ka drejtues galerish e muzesh që janë në atë post prej më se 20 vitesh. Dua të shtoj edhe diçka. Kur dëgjoja për herë të parë se u hap C.O.D. në Kryeministri, mendova se ishte zgjidhje e zgjuar, e cila do shërbente për edukimin nëpërmjet artit të politikanëve tanë; ata do merrnin atje një kulturë, që u mungonte, një kulturë që do t'i ndihmonte në mënyrën e të menduarit, të sjelljes dhe të vendimmarrjes. Jo më kot në kolegjet, ku studiojnë politikanët dhe diplomatët të vendeve të përparura, arti është pjesë e programit.

Patkeqësisht C.O.D. u kthye në një konkurrent të G.K.A., duke i marrë asaj fonde, publikun, aktivitetet. Mendimi im modest është se Galeria Kombëtare e Arteve meriton më shumë respekt, më shumë vëmendje, më shumë fonde, që të luajë rolin që i takon si institucioni i promovimit dhe zhvillimit të kulturës demokratike dhe artit pamor shqiptar.



KOMUNIKATË PËR SHTYP
Tiranë, 24 dhjetor 2018

RIKONCEPTIMI I ROLIT TË GALERISË SI PLATFORMË E SFËKËMBIMEVE NËRËKOMBËTARE

Në kuadër të dritës së re që është hapur në artin shqiptar dhe në kulturën ndërkombëtare sot, dhe si pasojë e problematikave që janë shfaqur ndër vite me Ekspozitën Ndërkombëtare të Arteve Pamore "Onufri", aktivitet ky që ka pasur mision primar realizimin e këtij shëmbimi në Shqipëri, Galeria Kombëtare e Arteve ka vendosur në mbylljen e "Onufrit" dhe rikonceptimin e programit të saj të përzgjedhës artistik.

"Onufri" u krijua së fundi të viteve '90-të si një domosdoshëri e kohës, që do të mundësonte shërbimet mes artistëve shqiptarë dhe atyre ndërkombëtarë, si dhe për të prezantuar artin e ri bashkëkohor të skenës vendase në kushtet e rrethës së plotë të institucioneve apo iniciativave të pavarura. Për këtë arsye, për vite me rradhë "Onufri" rrobajti pesëdhjetë kryesore të shëmbimit kulturor ndërkombëtar në artet pamore, duke i dhënë këstu një shprehje edhe



Pamje nga tërmeti që shkaktoi Etna në Sicili



Tërmet me magnitudë 4.8 në Katania, 28 të lënduar e në gjendje shoku

Etna trondit Italinë, thyhet statuja e shenjtit Sant'Emidios

Hiri vullkanik përfshin fshatrat, ndalohen fluturimet

Ditën e djeshme Italia është tronditur nga një tërmet me magnitudë 4.8 që goditi Sicilinë në orën 3:18 të mëngjesit, në pjesën përreth vullkanit më aktiv të Europës, Etna. Mediat italiane shkruajnë për 28 persona që kanë pësuar lëndime të ndryshme dhe janë gjendje shoku. Disa ndërtesa u dëmtuan pas lëkundjes së fundit që kur Etna shpërtheu të hënën. Hiri vullkanik kishte mbuluar më herët fshatrat pranë saj dhe fluturimet nga aeroporti i Katanias u ndaluan përkohësisht. Banorët e zonave përreth u këshilluan të largohen prej andej sa më shpejt. Mediat italiane thonë se njerëzit në zonë u përfshinë nga paniku dhe disa prej tyre kanë dalë me vrap nëpër rrugë. Ministria e Mbrojtjes, Elisabetta Trenta, ka shprehur në një postim në "Twitter" solidaritetin e saj me sicilianët për tërmetin në Katania. "Gati të ndihmohemi e të mbështesim popullsinë në këtë moment emergjence", shkroi ajo. 28 persona kanë marrë mjekim në spitale për shkak të tërmetit. Dhjetë persona janë dërguar me ambulanca në spital, ndërsa 18 janë paraqitur vetë. Pje-



Statuja e Shën Emidios e rëzuar nga tërmeti

sa më e madhe e tyre kanë paraqitur në gjendje shoku lëndime të lehta, disa janë ose të kapur nga gjendje

ancki. Ndërkohë është pezulluar për më shumë se 5 orë lëvizja hekurudhore në linjat Messina-Siracusa dhe Catania-Palermo. Është aktivizuar protokollin e sigurisë në rast të ndonjë tjetër lëkundjeje. Tre trena ronalë janë zëvendësuar me autobusë dhe dy ndërqytetas kanë lëvizur me 30 minuta vonësë. Për shkak të tërmetit, "Facebook" aktivizoi kontrollin e sigurisë, shërbimin që i lejon përdoruesit në rrezik të raportojnë statusin e tyre ose që, fatmirësisht, gjithçka është në rregull. Nëse jeni të sigurt, zgjidhni vetëm opsionin "Unë jam i sigurt" dhe sta-

tusi do të përditësohet me një njoftim. Në këtë mënyrë, miqtë dhe të afërmit do të dinë në kohë reale se jeni të sigurt. Nëse keni miq në zonë dhe opsioni është aktivizuar, do të njoftoheni për të gjithë ata që janë shënuar si të sigurt. Në Fleri u shemb një ndërtesë dhe dy persona të plagosur u nxorën nga rrënojat. Një zjarrfikëse dhe ambulanca mbërritën në vend. Rruga u mbyll menjëherë. Gjithashtu në Fleri janë regjistruar edhe shembje të tjera dhe ka njerëz të bllokuar nëpër shtëpi. Në rrugë, llambat janë thyer dhe ka rrjedhje gazi. "Jemi gjallë nga një mrekulli", tre-

gon një familje prej 4 anëtarësh, nëna, babai dhe dy fëmijë të mitur, pasi muret e shtëpisë së tyre janë shkatërruar. Të dëmtuara janë edhe shumë ndërtesa historike. Lëkundjet ishin aq të forta sa thyen edhe statujën e Sant'Emidios, që konsiderohet si shenjt i mbrojtës nga tërmetet. Autoritetet pezulluan mësimin dhe po kontrollojnë për dëme në ndërtesat e shkollave. Tërmeti 4.8 i shkallës Rihter ishte më i fortë pas disa lëkundjeve më të lehta të regjistruara prej të hënës kur u riaktivizua vullkani Etna, që ndodhet rreth 30 kilometra larg Katanias.

ARRATISJE NGA PARKIMI, HAJDUTËT SHKATËRROJNË MAKINAT

Të dielën në 23 dhjetor është zhvilluar një skenë si në filma në parkingun e supermarketit Tesco në Rickmansworth, në Hertfordshire, rreth 40 kilometra nga Londra. Dy persona në bordin e një "Citroeni" blu po përpiqeshin t'ia mbathnin pas një tentative për të vjedhur pije alkoolike brenda supermarketit dhe kanë përplasur të gjitha makinat që pengonin kalimin e tyre. Një punonjës i Tesco dhe disa klientë janë përpjekur të ndalojnë arratisjen e hajdutëve të dyshuar, duke i gjuajtur makinës së tyre me karroca. Mjeti më në fund ka arritur të largohet nga parkimi dhe policia është në ndjekje të makinës. Mediat lokale raportojnë që një punonjës i supermarketit ka mbetur i plagosur në brendësi të dyqanit, pak momente përpara kolapsit.



Zhduken 152 turistë gjatë pushimeve në Tajvan

Autoritetet tajvaneze janë në kërkim për 152 njerëz, që mbërritën në vend me viza turistike javën e kaluar, por që u zhdukën. Turistët arritën në qytetin jugor të Kaohsiung në datat 21 dhe 23 dhjetor, por të gjithë, përveç njërit prej tyre, duket se janë larguar, thonë zyrtarët. Mediat lokale raportojnë se turistët janë zhdukur me synimin për të punuar ilegalisht në Tajvan. Tajvanja ka hequr taksat e vizave për disa vizitorë nga vendet e Azisë, përfshirë Vietnamin, në një përpjekje për të rritur turizmin.

Trump: "Shutdown" sa të sigurojmë fondet për murin

Donald Trump, Presidenti i SHBA-ve, ka përsëritur dje se mbyllja e pjesshme e qeverisë federale ("shutdown") nuk do të revokohet deri sa të sigurohen fondet për ndërtimin e murit në kufi me Meksikën. Ai njoftoi se do të shkojë në kufirin me Meksikën në muajin janar për një vizitë në një pjesë të re të pengesës në ndërtim e sipër. "Nuk e di se kur do të rihapet qeveria, por mund t'ju them se nuk do të rihapet derisa të kemi një mur apo një gerdh, ta quajmë si të duan atë", tha Trump.

Japonia do të rifillojë gjuetinë e balenave në korrik

Japonia ka thënë se në muajin korrik do të rifillojë shitjen e mishit të balenave, një hap që pritet të nxisë kritika ndërkombëtare. Ky shtet ka thënë se do të largohet nga Komisioni Ndërkombëtar i Gjuetisë së Balenave (IWC). Gjuetia e balenave është ndaluar nga komisioni përgjegjës më 1986, pasi disa gjitarë kanë rrezikuar të zhduken. Mirëpo zyrtarët në Japoni që janë pjesë e Komisionit për Gjueti të Balenave nga viti 1951 kanë thënë se konsumimi i mishit të balenës është pjesë e kulturës së shtetit të tyre.

Eksporti i mallrave në Kosovë, Shqipëria kapërcen Serbinë

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për tregtinë e jashtme të Kosovës tregtar më të lartë për 4.2% në muajin nëntor 2018, në raport me muajin e njëjtë të vitit 2017. Përkthyer në shifra, sivjet deficitit është 240,2 milionë euro, ndërsa vjet ishte 230,5

milionë. Në muajin nëntor nga Kosova dolën mallra me vlerë mbi 34 milionë euro dhe erdhën mallra në vlerë rreth 275 milionë euro. "Eksporti i mallrave në muajin nëntor 2018 kishte vlerën 34,7 milionë euro, ndërsa importi 274,9 milionë euro", thuhet në njoftimin e ASK-së. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit, 36,4 për qind e përbëjnë metale bazë dhe artikujt prej

tyre, 13,5 për qind produktet minerale, 12,8 për qind plastika, goma dhe artikujt prej tyre, 8,1 për qind ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, 6,4 për qind prodhimet bimore, 3,8 për qind artikujt e ndryshëm të prodhuar, 3,2 për qind tekstili dhe artikujt prej tij etj. Mallrat që erdhën më shumë në Kosovë ishin produkte minerale, makineri e pajisje mekanike. "Ndërsa, sipas të dhënave të

grupeve kryesore për import: 10.3% metalet bazë dhe artikujt prej tyre, 7.8% mjete të transportit, 6.9% plastika, goma dhe artikujt prej tyre, 6.4% e përbën tekstili dhe artikujt prej tij, 6.0% prodhimet e industrisë kimike etj.", bën të ditur komunikata. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (16.6%), Maqedonia (10.5%), Serbia (8.3%), dhe Mali i Zi (6.9%)", tregojnë statistikave të ASK-së. Pra, nga vendi parë që kishte për vite të tëra, tashmë në vend të parë të eksportit të mallrave për në Kosovë është Shqipëria.



Foto ilustruese

Kuvendi, seancë të jashtëzakonshme për draftin gjithëpërfshirës me Serbinë

Mblidhet ekipi negociues në Kosovë, në 8 janar takimi në Bruksel

Thaçi: Hezitetit të mbajnë përgjegjësi, të mbyllet procesi

Gjatë ditës së djeshme udhëheqësit më të lartë të institucioneve të Kosovës dhe ekipi negociator për dialog me Serbinë kanë zhvilluar takimin e parë të përbashkët për të diskutuar hapat e ardhshëm në kuadër të fazës finale të bisedimeve në Bruksel, që po lehtësohen nga Bashkimi Evropian. Takimi ishte thirrur nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Aty kanë marrë pjesë edhe presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj si dhe bashkëkryesuesit e ekipit negociator, Fatmir Limaj e Shpend Ahmeti. Pas takimit është bërë e ditur se ekipi shtetëror i Kosovës më 8 janar të vitit 2019 është i ftuar për një takim në Bruksel. Ata janë zotuar për një proces transparent, duke besuar se rezultat i dialogut duhet të jetë njohja e Kosovës nga Serbia, si një lloj parakushti që i mundëson Kosovës më pas anëtarësimin e saj në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe përsheptim në anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian dhe NATO. Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli tha se Kosova është në rrugë të mirë dhe kërkoi që në këtë proces të jenë të gjithë së bashku. "Është i proces i lirisë, është proces i të sovranitetit të territorëve të shtetit tonë të pavarur dhe sovran. Është proces që Serbia të njohë Kosovën si shtet dhe të fitojmë ulësen në OKB-së. I tërë procesi është transparent, do të jetë i plotë dhe përgjegjësi. Kosova e ka zotimin e vet për dialog para institucioneve, para qytetarëve, para partnerëve ndërkombëtarë. Kosova ka njerëzit e vet që do t'i dalin zot vendit", tha Veseli. Në anën tjetër, Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi tha se duke qenë më të koordinuar dhe të bashkuar, do të ketë sipas tij, edhe sukses në angazhimet për arritjen e një marrëveshjeje finale Kosovë-Serbi. "Ky unitet i qëndrueshëm i institucioneve,

HASHIM THAÇI
"Ky unitet i qëndrueshëm, bartës i institucioneve, ekipi negociator, shoqëria civile është një thirrje edhe për hezitetit e këtij procesi që të marrin përgjegjësi për përmbylljen e këtij procesi final Kosovë-Serbi", tha Thaçi.



Presidenti Hashim Thaçi dje në Kuvendin e Kosovës

ekipi negociator, shoqëria civile është një thirrje edhe për hezitetit e këtij procesi që të marrin përgjegjësi për përmbylljen e këtij procesi final Kosovë-Serbi", tha Thaçi. Ndërkaq, kryeministri Ramush Haradinaj tha se mirëpret çdo ide dhe sugjerim rreth dialogut Kosovë-Serbi, por asnjëherë në tavolinat e bisedimeve nuk do të flitet apo negociohet për shkëmbim të territorëve.

"Qeveria e vendit, me qëllim që ekipi negociator të vihet në korniza ligjore, ka miratuar projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror si dhe ka sponsorizuar hartimin e draftmarrëveshjes, librin e madh me shumë kapituj, që është shkruar nga ekspertët e qeverisë, duke e pajisur ekipin negociator të vendit me një materie të gjallë,

8 JANAR
Ekipi negociator do të ketë takim në Bruksel për të diskutuar mbi ecurinë e procesit të dialogut. Kështu ka thënë kryetari i Partisë Socialdemokrate, Shpend Ahmeti, përfaqësuesi i subjektit të vetëm opozitar në këtë ekip negociator.

gjithëpërfshirëse dhe të hapur", theksoi Haradinaj. Kryetari i Partisë Socialdemokrate, Shpend Ahme-

ti, përfaqësuesi i subjektit të vetëm opozitar në këtë ekip negociator tha se më 8 janar se ekipi negociator

do të ketë takim në Bruksel për të diskutuar mbi ecurinë e procesit të dialogut.

HASHIM THAÇI
Ramush Haradinaj "Qeveria e vendit, me qëllim që ekipi negociator të vihet në korniza ligjore ka miratuar projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror si dhe ka sponsorizuar hartimin e draftmarrëveshjes, librin e madh me shumë kapituj, që është shkruar nga ekspertët e qeverisë, duke e pajisur ekipin negociator të vendit me një materie të gjallë, gjithëpërfshirëse dhe të hapur", theksoi Haradinaj.

MAQEDONI



Talat Xhaferi

Shqiptari në krye të Maqedonisë? Ja kush mund të bëhet president

Qeveria në Maqedoni do të nisë ndryshime të reja kushtetuese për zgjedhjen e presidentit, në mënyrë që ai të zgjidhet në Kuvend në rast se opozita vendos të bojkotojë zgjedhjet - thonë nga burimet e qeverisë. Derisa të zhvillohen procedurat për ndry-

shimet të cilat zgjasin 100 ditë, detyrën e presidentit sipas Kushtetutës së Maqedonisë përkohejshëm do ta kryejë kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi. Zgjedhjet presidenciale duhet të paraqiten në 2 ose 3 shkurt, ndërsa duhet të zhvilloheshin në fund të muajit mars.

Dje në "Newsweek"

Procedura e shkarkimit të Donald Trump mund të fillojë që tani

Nga Elizabeth Holtzman

(vijon nga faqja 1)

... se si do të reagojnë ndaj kësaj nisme mbështetësit e Trump, dhe duke u shqetësuar se kjo do të polarizojë më tej një komb tashmë tejet të ndarë, apo se s'do të ketë vota të mjaftueshme në Senat për ta dënuar atë, edhe nëse Kongresi voton pro fajësimit dhe shkarkimit.

Unë s'kam frikë. Si një kongresmene e re, më e reja e zgjedhur ndonjëherë në atë kohë, shërbeva në Komisionin Gjyqësor të Kongresit, që votoi për të fajësuar presidentin Nikson për krimet dhe shkeljet e rënda që ai kreu në lidhje me skandalin Uotergejt dhe çështje të tjera.

Për të vlerësuar drejt rastin Trump, duhet të lëmë mënjanë sulmet e tij të palodhura ndaj mjedisit, aleatëve tanë të ngushtë, dhe gati çdo reforme të ndërmarrë nga presidenti Barak Obama (duke përfshirë Aktin e Kujdesit të Përballeshëm Shëndetësor), dhe çdo mosmarrëveshje mbi politikat apo çdo sulm personal.

Me Trumpin që po tenton sërish të hedhë poshtë hetimin e prokurorit special Robert Myler si një "gjueti shtrigash", me mund të lëmë jashtë diskutimit edhe çështjen e lidhjeve të tij me Rusinë. Ka akoma shumë vepra të tjera padiskutueshme. Dy nga më të rëndat janë refuzimi i Trump për t'u shpëputur nga interesat e tij të biznesit (një shkelje e mundshme e ndalimit të ryshfetit, dhe klauzolës së shpërblimit në Kushtetutë) dhe miratimi prej tij i politikës së emigracionit që lejon "ndarjen e familjeve" (një shpërdorim potencial i pushtetit).

Ryshfeti godet në zemër demokracinë, dhe rrezikon seriozisht vendin. Kjo është një nga arsytet, se përse është përcaktuar në Kushtetutë si një shkak i fortë për fajësim. Pasi një president që anon nga ryshfeti, nuk vepron më në interesin më të mirë të vendit dhe të popullit të saj.

Trump është sigurisht një objekt kryesor për një akuzë të



tillë, pasi ndryshe nga paraardhësit e tij, ai nuk ka pranuar të ndahet nga interesat e tij të shumta dhe të largëta të biznesit, si hotelet dhe kurset e golfit dhe ende nuk është në gjendje, përdërisa presidenti po fiton ende para nga ato biznese.

Ryshfetet mund të maskohen lehtë në kontekstin e biznesit - për shembull, nga pagesat e majme për prona, mallra ose shërbime. Tre transaksione të fundit që përfshijnë Trump, ngrenë dyshime mbi ryshfetin, dhe duhet të hetohen plotësisht. Pasi vuuri në pikëpyetje politikën "Një Kinë" të Pekinit, Trump ndryshoi kurs pasi qeveria kineze miratoi markat tregtare të Trump.

Ky model sjelljeje shtrihet edhe në Lindjen e Mesme. Në qershorin e vitit 2017, Trump iu bashkua një koalicioni shtetesh në një bllokadë kundër Katarit, të cilin e quajti "një sponsor të madh të terrorizmit". Një vit më vonë, Katar i bë "një mik i madh", pasi një partner madhor i qeverisë së Katarit pra-

noi të financojë ndërtimin e nnë godine në Manhattan në pronësi të dhëndrit të Trump dhe këshilltarit të presidentit, Xhared Kushner.

Ashtu si me ryshfetin, hartuesit e Kushtetutës nuk japin përkufizim mbi shpërblimet, që janë "kushërinjte e parë" të ryshfetit. Nga Endrju Xhekson tek Barak Obama, presidentët amerikanë kanë kërkuar miratimin e Kongresit apo të Departamentit të Drejtësisë, në lidhje me përshtatshmërinë e shpërblimeve të mundshme, më së fundmi çmimi Nobel për Page prej më shumë se 1 milion dollarësh që iu dha Obamës.

Departamenti i Drejtësisë, arri- ti në përfundimin se çmimi nuk ishte i papërshtatshëm, pasi nuk ishte dhënë nga një "Mbret, Princ ose Shtet i huaj". Presidentët e tjerë përpara Trump, duke përfshirë Abraham Linkolin dhe Ronald Reagan, u përpoqën me përpikëri që t'i përmbaheshin klauzolave.

Refuzimi i Trump për t'u bërë pjesë e këtij shqetësimi - në fakt,

përbuzja e tij totale për të - është ajo që e bën trajtimin e tij mbi shpërblimet një shkelje të madhe dhe të rrezikshme. Linja e hollë midis biznesit të tij personal dhe detyrës si qeveritar, veçanërisht në fushën e punëve të jashtme, përbën një rrezik të afërt për SHBA-në, dhe refuzimi i palëkundur i tij për të ndrequr problemin mund të përbëjë një krim të rëndë.

Në një shkelje të hapur të klauzolës së shpërblimeve të huaja, diplomatët e huaj kanë zgjedhur vazhdimisht të qëndrojnë në kullën "Trump International", pavarësisht se ajo ka qiratë më të larta në Nju Jork. Trump ka fituar kësajqësi miliona dollarë.

Ndërkohë ndarja e fëmijëve nga prindërit (kur bëhet jo për të mbrojtur fëmijën) nuk është thjesht "e tmerrshme", siç ka thënë ai vetë. Ajo është mizore dhe morale. Për më tepër, duket se një nga motivet e Trump në hartimin e këtij programi "të tmerrshëm", ishte t'i detyronte demokratët të pranonin politikat e tij të emigracion-

it, duke përfshirë edhe ndërtimin e murit me Meksikën.

Armigësia e Trump ndaj hispanikëve është e mirënjohur. Ai i cilësoi meksikanët si "përdhunues" gjatë fushatës së tij presidenciale, e quajti Salvadorin një "vend të qelbur", dhe në muajin maj tha për emigrantët pa dokumente nga Amerika Qendrore dhe Meksika: "Ju nuk e besoni se sa njerëz të këqij janë ata. Ata nuk janë njerëz. Ata janë kafshë!".

Zbatimi i një programi të ndarjes së fëmijëve nga prindërit mbi baza raciale ose etnike, përbën një shpërdorim të pushtetit, dhe shkel, gjithashtu, të drejtat kushtetuese të fëmijëve dhe prindërve për mbrojtje të barabartë ligjore. Një president që u ka shkaktuar qëllimisht dëme të rënda mendore dhe psikologjike mijëra njerëzve, dukshëm mbi baza etnike, për të trembur të tjerët, e ka shkelur Kushtetutën me të dyja këmbët.

Marr me shkurtime nga Newsweek - Bota.al



BLUE TOOTH

THASHETHEME
MADE IN
ALBANIA



te rejat nga jeta

ipave

çdo të shtunë falas me

Dje në "Reporter.al"

Kosovë: Thirrren në Hagë komandantët e parë guerilas

Nga Die Morina

(vijon nga faqja 1)

... u shfaqën vetëm në dhjetor të këtij viti, kur disa ish-anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK-së, u ftuan të merreshin në pyetje në Prokurorinë e Specializuar në Hagë.

Ftesa e parë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar pas tri vitesh heshtjeje i shkoi Rustem Mustafës, një ish-komandant i UÇK-së, i njohur edhe si Remi, të cilit iu kërkua të merrej në pyetje në Hagë më 14 janar. Megjithatë, ende nuk është e qartë nëse ai do të merret në pyetje si i dyshuar apo si dëshmitar.

Dhomat e Specializuara dhe Prokuroria e Specializuar e Kosovës janë pjesë e sistemit ligjor të Kosovës, por ndodhen në Holandë dhe kanë për detyrë të hetojnë dhe të gjykojnë të dyshuarit për krimet e kryera gjatë dhe menjëherë pas luftës së Kosovës, 1998-2000.

E ashtuquajtura "Gjykatë Speciale" pritet të padisë figurat e larta të UÇK-së për krime të dyshuara, duke përfshirë vrasje, rëmbime, ndalime të paligjshme dhe dhunë seksuale. Ajo ende nuk ka bërë publike ndonjë akuzë.

Ish-komandanti Sami Lushtaku dhe ish-kreu i gjykatës ushtarake të UÇK-së, Sokol Dobruna, u ftuan gjithashtu të flasin me prokurorët. "Unë mendoj se mund të jem ose dëshmitar, ose i pandehur, por nuk kam asnjë ide se pse jam thirrur", tha Dobruna.

Ai u zotua të bashkëpunojë dhe mohoi që UÇK-ja të ketë qenë e përfshirë në krime lufte.

Por, ish-komandanti i njësisë së UÇK-së, Remzi Shala, i njohur gjatë kohës së luftës si "Molla e Kuqe", tha se nuk do t'i përgjigjet ftesës, duke shpjeguar se ai nuk i beson Dhomave të Specializuara të Kosovës, të cilat priten të gjykojnë ish-figurat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të paditur nga Prokuroria e Specializuar.

E ashtuquajtura "Gjykatë Speciale" nuk pëlqehet gjerësisht në Kosovë, pavarësisht se është pjesë e sistemit të drejtësisë të vendit. Shumë shqiptarë të Kosovës besojnë se ajo denigron atë që ata e shohin si lufta e drejtë e UÇK-së për çlirimin nga sundimi serb.

Por kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, vetë një ish-komandant i UÇK-së, i cili u lirua nga akuzat për krime lufte nga Gjykata e Hagës, tha pasi ish-shokët e tij u thirrën për t'u marrë në pyetje në Hagë se ata duhet të bashkëpunojnë me prokurorët. "Lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe e shenjtë dhe kjo do të vërtetohet", tha ai.

Prokuroria e Specializuar deri më tani nuk ka konfirmuar të ketë



thirrur ndonjë nga ish-luftëtarët për ta marrë në pyetje.

Zëdhënësi i saj, Christopher Bennett tha se "Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk jep informacion mbi statusin e hetimit, por synon të sigurojë që të gjitha pohimet e përbajtura në raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës të përpiluara nga Senatori zviceran Dick Marty do të trajtohen dhe do të hetohen plotësisht".

Raporti i Dick Marty, i botuar në vitin 2010, pretendonte se disa zyrtarë të lartë të UÇK-së ishin përgjegjës për abuzime serioze të të drejtave të njeriut.

Ndalohej të dyshuarit në rastin e Ivanoviçit
Oliver Ivanoviç, lideri i një partie serbe të Kosovës e quajtur Liri, Demokraci dhe Drejtësi u qëllua jashtë zyrës së tij në qytetin e ndarë të Mitrovicës në janar 2018, por u desh gati një vit që autoritetet të arrestonin ndonjë të dyshuar.

Hetimi, i kryer në mes të një atmosfere armiqësie dhe mosbashkëpunimi midis Kosovës dhe Serbisë, duket se nuk po shkonte askund, derisa Policia e Kosovës organizoi një operacion në Mitrovicë, që solli arrestimin e tre personave të dyshuar të lidhur me vrasjen.

Dy prej tyre janë anëtarë serbë të forcës policore të Kosovës, ndërsa i treti është një anëtar i klubit të tifozëve të Partizanit të Beogradit. Prokurorët besojnë megjithatë, se ata thjesht mbështetën vrasjen, ndërsa vrasësi i vërtetë vazhdon të mbetet i lirë.

Sekretarja në selinë e partisë së Ivanoviçit u ndalua gjithashtu për pak kohë nën dyshimin se kishte futur duart në kamerat e sigurisë të zyrës.

Por një tjetër i dyshuar, biznesmeni Milan Radoiçic, nënkryetar i partisë kryesore serbe të Kosovës, Lista Sebe, arriti ta shmange arrestimin dhe u arratis në Serbi.

Radoiçic u përshkrua si mbajtësi i vërtetë i pushtetit në rajonin më serb të veriut të Kosovës nga Ivanoviç pak kohë para se ai të qëllohej për vdekje.

Një deklaratë në lidhje me Radoiçicin në faqen e "Facebook"-ut të Listës Serbe pohoi se policia e Kosovës ka bastisur banesën e tij "të armatosur deri në dhëmbë, me vetëm një qëllim - për të më vlarë". Presidenti serb, Aleksandër Vuçiq këmbënguli gjithashtu që Radoiçic ishte i pafajshëm.

Në kohën e vdekjes, Ivanoviç po gjykohej për urdhërimin e vrasjes së shqiptarëve të Kosovës gjatë luftës në vitin 1999. Ai e deklaroi veten të pafajshëm.

Politikani Fatmir Limaj lirohet përsëri nga akuzat

Një gjykatë apeli në nëntor la në fuqi vendimin për lirimin nga akuzat të ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fatmir Limaj, i cili tani është zëvendëskryeministër, duke e liruar atë nga përgjegjësia për vrasjen e dy civilëve shqiptarë etnikë në tetor 1998.

Limaj u gjet i pafajshëm për akuzat se ai nuk mori masa të arsyeshme dhe të nevojshme për të parandaluar vrasjet. Aktakuza kishte pretenduar se Limaj pa tru-

pat e viktimave dhe ishte i vetëdijshëm për kryerjen e krimin. Por, gjykata e apelit tha se gjyqi fillestar nuk paraqiti "asnjë provë të vetme që i akuzuari kishte kryer veprën penale".

Ish-komandanti guerilas, tashmë i kthyer në politikan, i cili aktualisht drejton partinë Nisma (Nisma Social Demokrate), është gjykuar dhe është gjetur jo fajtor për krime lufte disa herë në të kaluarën nga gjykatat në Kosovë dhe Hagë.

Një oficer rezervist serb, Zoran Vukotić, u lirua gjithashtu nga akuzat në vitin 2018 për kryerjen e krimeve të luftës kundër civilëve shqiptarë etnikë.

Vukotić u gjet i pafajshëm në mars për rrahjen dhe më pas vrasjen e katër burrave në Vushtri në maj 1999 dhe për përfshirje në mbajtjen e paligjshme të 17 civilëve në një ish-ndërtesë bujqësore në Vushtri.

Ish-polic i lirua më tej nga akuzat për plaçkitje me dhunë të parave, sendeve prej floriri dhe sendeve të tjera të çmuara nga të tre civilët.

Në një rast tjetër të këtij viti, një burrë i quajtur Skënder Bislimi u gjet fajtor në tetor 2018 për krime lufte kundër civilëve shqiptarë etnikë në Fushë-Kosovë.

Prokuroria pretendoi gjatë gjyqit se Bislimi dhe dhjetë paraushtarake serbë ngritën një pikë kontrolli në një kryqëzim në Fushë-Kosovë, ku torturuan shqiptarët e Kosovës, të cilët ishin detyruar të largoheshin nga shtëpitë e tyre tri ditë pasi filloi fushata e bombardimeve të NATO-s kundër Jugosllavisë, në mars 1999.

HOROSKOPI

DASHI

Dita e sotme ju mbush me dashuri dhe dëshirë bashkëpunim. Do të shkëlqeni në sektorin e martesës. Fat i mirë parashikohet në çështje pronash ose familjare. Edhe humori do të jetë optimal.

DEMI

Në punë do të jeni më të mirët. Të vetëpunësuar apo të punësuar, jeni të favorizuar për projektet më të mira që vijjnë. Klientët apo drejtuesit tuaj do t'ju duan, besojnë dhe do të duan t'ju kenë pranë.

BINJAKET

Nëse ndjeni se nuk keni romancë në jetën tuaj, sot dita do të jetë plot fat. Nëse jeni beqar/beqare dhe jeni në kërkim të njeriut të duhur, dita do t'ju japë mundësi më të mëdha për të takuar një njeri interesant.

GAFORJA

Nëse keni projekte për rregullimin e shtëpisë, sot është koha ideale për t'i nisur. Vëmendja juaj do kalojë shpejt te karriera. Lajmet që do të merrni në dashuri nuk do të jenë çfarë kishit pritur.

LUANI

Kjo ditë mund të krijojë konfuzion dhe paqartësi. Mundohuni t'u kushtoni rëndësi problemeve në dashuri. Këshilloheni që të kaloni më shumë kohë me miqtë tuaj gjatë pasdites.

VIRGJERESHA

Parashikohet një ditë me fat për sa u përket parave. Nuk jeni materialist, por të pasur. Mundohuni t'u kushtoni rëndësi problemeve në dashuri. Këshilloheni që të kaloni më shumë kohë me miqtë tuaj gjatë pasdites.

PESHORJA

Universi do korrigjë gabimet e së shkuarës dhe frustimet që ju kanë penguar deri tani do të zhduken. Do t'ju duhet të tregoheni më aktivë punë. Bëni mirë ta shfrytëzoni duke qenë se keni pasur shumë pak momente të tilla të arta.

AKREPI

Pa marrë parasysh se çfarë ndodh sot, mos harroni një gjë: ju mund të merrni gjithë kohën që ju nevojitet. Bëjeni çdo gjë me kujdes, me ngadalë dhe pa u nxituar fare. Kështu do të keni sukses.

SHIGJETARI

Në këtë ditë do të prekeni nga kujdesi që një mik mund të shfaqë për ju, ose mund të bashkoheni me një grup të caktuar, të cilët do t'ju ndihmojnë në shumë aspekte. Një marrëdhënie romantike mund të rezultojë shumë e qëndrueshme.

BRICJAPI

Sot mund të bëni një prezantim ose një intervistë për një hap të rëndësishëm në karrierë. Do ju duhet të përdorni një sasi të konsiderueshme parash për të rregulluar disa problemet që mund të shfaqen.

UJORI

Lajme të mira parashikohen sa i përket karrierës. Në çështjet e romancës, gjërat do ju shkojnë shumë mirë. Një horizont më i gjerë ju pret tani dhe do të shihni shumë mundësi në çdo gjë që prekeni.

PESHQIT

Do të jeni thellësisht të frymëzuar në aspektin profesional për të nisur një projekt të ri. Sa i përket dashurisë, gjërat do të vijnë duke u rregulluar hap pas hapi. Me paratë tregoni më shumë kujdes.

KAMPIONATI ITALIAN

Juventus i Masimiliano Alegri ndalet në Bergamo, por edhe aty tregon se është një skuadër e madhe. Bardhezinjtë edhe pse luajtën për gati një pjesë loje me një lojtar më pak dhe e nisën ndeshjen pa Ronaldon në formacionin titullar; arritën të merrnin një barazim 2-2, duke ruajtur pafytyrësinë në kampionat dhe duke vijuar marshimin drejt titullit të 8-të radhazi në Serie A. Juventus gjeti shumë shpejt avantazhin që në minutën e 2-të me një autogol të Be-

rat Gjimshitiit me mbrojtësin e Kombëtares shqiptare, që ishte i pafat në devijimin e tij, duke mos i dhënë asnjë mundësi për të reaguar Etrit Berishës. Megjithatë, e shtyrë edhe nga mbështetja e fortë e publikut vendës në Bergamo, Atalanta reagoi dhe gjeti golin e barazimit me Duvan Zapatan, i cili pasi shmangu Bonuçin, goditi bukur nga limitet e zonës duke i çuar shifrat në 1-1. Në minutën e 53-të, Juvja mbeti me 10 lojtarë pasi Bentankur mori kartonin e dytë të verdhë. Nuk vonoi shumë dhe Atalanta përfitoi

Ronaldo shpëton Juven ndaj Atalantës, Milani është në krizë

nga inferioriteti numerik i bardhezinjve, duke realizuar sërish me Zapatan. Në këtë moment reagoi Alegri, që hodhi fillimisht në fushë boshnjakun Pjaniç dhe disa minuta më pas Kristiano Ronaldon. Me kalimin e minutave, edhe pse me një lojtar më pak, kampionët e Italisë fituan shumë terren me Atalantën që ndjeu lodhjen. Në minutën e 78-të Ronaldo i shërbyer nga Manx-ukijç brenda zone realizoi me

kokë duke barazuar shifrat në 2-2, rezultat që nuk ndryshoi deri në fund. Ky ishte goli i 12-të në këtë sezon të Serie A për yllin portugez. Duelin mes dy vëllezërve e fitoi Simone Inzaghi me Lacion, që mposhti 2-0 Bolonjan në transfertë falë golave të Luiz Felipes dhe Lulijç, duke ruajtur vendin e 4-t. Nëse Filippo Inzaghi shkarkohet nga stoli i skuadrës kugeblu pas kësaj humbjeje, atëherë fajin duhet ta mbajë

SERIA A	
TE MERKUREN	
Frozinone - Milan	0-0
Fiorentina - Parma	0-1
Atalanta - Juventus	2-2
Bologna - Lazio	0-2
Kajliari - Xhenoa	1-0
Sampdoria - Kievo	2-0
Roma - Sasuolo	3-0
Torino - Empoli	3-0
SPAL - Udineze	

vëllai i tij i vogël, Simone. Zhgënjëu Fiorentina që u mposht 0-1 në shtëpi nga Parma me Inglesen që shënoi golin e vetëm të sfidës. U ngjiti në vendin e 5-të të renditjes

Sampdoria falë suksesit 2-0 ndaj Kievos, ndërkohë që Kajliari kaloi 1-0 Xhenoan. Krizë e thellë kugezi. Milani nuk po arrin të dalë nga tuneli i errët, ku është futur që prej dhjetorit. Skuadra e Gatzos nuk di më të shënojë dhe "agjëron" për shpëtim ndeshjesh. Torino, Bologna, Fiorentina dhe Frozinone. Katër ndeshje kampionati, 379 minuta pas gjetur rrugën e rrjetës. Gëzimi i fundit për një gol të Milanit është ai i shënuar me penallti nga Kesi kundër Parmës, ndër- sa ndaj Frozinones përfundoi 0-0.

Për mbrojtësin, dobësimi i Skënderbeut ka sjellë garën e fortë në Kategorinë Superiore



Jeton Selimi

Arap: Do të rikthehesha për të luajtur me Teutën

Por gjithsesi pret rinovimin me Bolusporin

Mbrojtësi i majtë, Renato Arapi, i njohur në kampionatin shqiptar për përvojat me disa skuadra, si Dinamo, Besa, Skënderbeu dhe Partizani, sezonet e fundit ka luajtur në Turqi. Por aventura e fundit me Afjet Afion Afionsport nuk ka qenë pozitive për të dhe durrësaku ka dhënë sinjale rikthimi në kampionatin tonë: "Ka qenë sigurisht zgjedhja ime dhe e menaxherit e gabuar edhe eksperiencia e këtyre muajve të fundit e ka treguar që edhe ekipi nuk ka qenë në nivelin e duhur. Të them të drejtën jam penduar, nuk është se ishte zgjedhja ime 100%, unë thjesht i besova menaxherit, sepse ata e njohin edhe më mirë ambientin atje edhe klubet, por që ka pasur shumë mungesë të theksuar të organizimit". Kontrata me klubin turk përfundon në qershor të vitit 2019, por mbrojtësit i mungon dëshira për të vi-



juar përvojën e tij tek Afjonspori. "Shumë lojtarë që ndoshta kanë qenë nga

liga amatore kanë qenë edhe pjesë e ligës profesionale që luajmë tani dhe

kjo ndoshta ka sjellë edhe vështirësitë e veta. Nuk mund të them se e kam

mbyllur, sepse përderisa unë kam kontratë, do të thotë se unë jam akoma i lidhur me atë klub, pavarësisht se dëshira ime personale është që të lëviz nga ky klub, nuk e di se ku po të lëviz nga ky klub". Rikthimi në Shqipëri është një opsion që po konsiderohet nga 32-vjeçari dhe jo thjesht në Shqipëri, por një rikthim tek klubi i zemrës, fanellën e të cilit si për ironi nuk e ka veshur kurë si profesionist. "Gjithmonë e kam pasur dëshirën për t'u kthyer në Shqipëri, në momentin që unë nuk do të kisha mundësi për të gjetur një ekip në Turqi me ato kushte që kërkoj, sigurisht që ardhja në Shqipëri është

shumë e mundur. Nuk mund ta mohoj dëshirën, duke qenë se edhe unë jam nga qyteti i Durrësit, s'do ishte keq". Në fund nuk mund të mungonte një opinion i shkurtër i Renato Arapin në lidhje me kampionatin shqiptar dhe ecurinë e skuadrave rivale për titull. "Më vjen mirë që në kampionat ka konkurrencë, janë 3 ose 4 ekipe që luajnë për vendet e Kupave të Europës, sigurisht kjo ka ardhur edhe për shkak të dobësimit të Skënderbeut, duke shitur lojtarët bazë të ekipit dhe kjo ka sjellë ndoshta një nivel më të ulët të Skënderbeut, por që e ka bërë kampionatin më të bukur", ka përfunduar Arapi.

Renditja e UEFA-s për klube

Skënderbeu, shumë përpara klubeve të tjera shqiptare

UEFA ka përditësuar ditën e sotme edhe renditjen e të gjitha ekipeve europiane, në listën e përgjithshme sipas koeficientit të klubeve, në muajin dhjetor. Ekipet shqiptare, duke mos pasur asnjë angazhim në Europë, kanë mbetur pa lëvizur ndërsa vetëm Skënderbeu ka pësuar zbritje. Korçarët kanë zbritur në vendin e 157-të, gjithsesi korçarë vazhdojnë të bëjnë "ligjin" për sa u përket klubeve shqiptare. Ndërsa ekipi i radhës shqiptar në renditje është Kukësi, që mban vendin e 213-të. Partizani vjen i 322-ti, ndërsa ndjekin Laçi, Flamurtari, Tirana, Teuta dhe Flamurtari, që gjenden shumë pranë në renditje me njëra-tjetrën. Pavarësisht se "Demat e Kuq" udhëheqin kampionatin, Skënderbeu rezultoi 165 vende sipër skuadrës kryeqytetase. Nga ekipet e Superligës së Kosovës, Drita mban vendin e 372-të, ndërsa më pas Prishtina në të 402-tin dhe Trepça 89 në vendin e 447-të. Ekipi shqiptar i Shkëndijës së Tetovës në Maqedoni kryeson listën e maqedonaseve, në vendin e 177-të, ndërsa Shkupi renditet i 361-ti. Ndërkohë, renditja kryesohet nga Reali i Madridit, ndërsa ndjekin Bajerni i Mynihut dhe Barcelona në podium. E katërta vjen Atletiko e Madridit, ndërsa Juventus i në vendin e pestë.

KAMPIONATI ANGLEZ

Boxing Day i solli fat Liverpoolit të Jurgen Klop. "The Reds" vazhduan serinë e fitoreve duke e çuar në 8 numrin e suksesive radhazi dhe duke mbyllur në mënyrë perfekte fazën e parë. Në "Anfield Road" Liverpooli kaloi lehtësisht me rezultatit e thellë 4-0 Njukastëll Junajtid, duke regjistruar fitoren e 16-të në 19 takime në të cilat nuk njih humbje. Serinë e golave për skuadrën e Klop e hapi qendërmbrojtësi Dejan Lovren, ndërsa në pjesën e dytë shënuan Salah me penallti, Shaqiri që realizoi golin e 6-të sezonal dhe mbylli llogaritë Fabinjo me golin e tij

Liverpuli "fluturon" me Shaqirin, Siti vijon me humbjet


të parë me fanellën e "The Reds". Një fitore 4-0 e Liverpoolit që e ngjiti në kuotën e 51 pikëve, 6 më shumë se vendi i dytë që tashmë nuk mbahet më nga Manchester Sitiit. Xherdan Shaqiri edhe në këtë sfidë ishte një nga më të mirët në fushë, duke e nisur ndeshjen si titullar dhe duke u konfirmuar se ka qenë ai blerja më e mirë e Liverpoolit në merkaton e verës, pasi edhe pse u transferua pa shumë bujë, futbolli- sti me origjinë shqiptare po luan shumë më tepër se dy blerjet e bujshme Fabinjo dhe Keita. Manchester Siti në mënyrë befasuese pësoi

humbjen e dytë radhazi pasi u përmbys në "King Poëer Stadium" nga Leicester Siti që triumfoi me rezultatit 2-1. Goli të Bernardo Silvës iu përgjigjën Allbrajton dhe Rikardo Pereira. Vazhdon momenti "Jo" për skuadrën e Guardiolaes, që me këtë disfatë zbriti në vendin e 3-të, pasi u parakalua në renditje edhe nga Tottenham Hotspur. Skuadra e Mauricio Pokenos shënoi 5 herë në "Wembley" në portën e Bornmautit për të marrë fitoren e 5-të radhazi dhe për t'u konfirmuar se është një pretendente serioze në garën për titull. Në këtë sfidë spikati

PREMIER LIGA	
TE MERKUREN	
Fulham - Ulverhampton	1-1
Bërnlaj - Everton	1-5
Kristal Palas - Kardif	0-0
Leister - Mançester Siti	2-1
Liverpul - Njukastërr	4-0
M. Junajtid - Hadersfild	3-1
Totenham - Bornmaut	5-0

Son me një dygolësh ndërsa shënuan edhe Eriksen, Lukas e Kejn. Mori fitoren e dytë radhazi Mançester Junajtid me Ole Gunar Solksjaer në stol. Në "Old Trafford", "Dajajtë e Kuq" mposhtën 3-1 Hadersfild në një ndeshje, ku Paul Pogba bëri liderin e vërtetë duke realizuar dy gola, ndërsa ai që zhblokoi shifrat ishte Nemanja Matić.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. Miller e Verdi-t.
- 5. Më e mira është rekord.
- 9. Inicialet e Deraïn.
- 11. Kishte 100 Teba.
- 12. Është vija e portës
- 13. Në fund të rritjes.
- 14. Drejtori Lokale Përmet.
- 15. Inicialet e Seagal.
- 16. King Cole i muzikes.
- 17. Ishte shpendi simbol i Jezu Krishtit.
- 21. Artikulli spanjoll.
- 23. Janë fjalëpake.
- 25. Fillojnë titrat.
- 26. Është i mërzitshmi.
- 27. Ashtu si jeton heremiti.
- 29. U kompozua nga Ravel.
- 30. Janë spanjollët dhe portugezët.
- 32. Një kitarë indiane.

- 33. Janë edhe ato të sigurimit.
- 35. Është e harlisur në xhungël.
- 37. Mbyllin fushatat.
- 38. Kështu thirrej Eisenhower.
- 40. Ai dhe ajo.
- 41. Fillojnë vallen.
- 42. Inicialet e Delon.
- 44. Kalohet në gjumë.
- 45. Martini që qe këngëtare
- 46. Një thirrje me emra.

VERTIKAL

- 1. U quajt qyteti atomik.
- 2. Qyteti i Abrahamit.
- 3. Italia në tabela.
- 4. Sapo fillojnë.
- 5. Nemo ai i Nautilus.
- 6. Janë në botë
- 7. Një tabu islamike
- 8. I famshmi Pacino.
- 10. Janë si falimentime
- 11. Ngjyhet një në tavolocë.
- 12. Timo i Mato Grudës.
- 14. Janë borxhlinj.
- 17. E përditshmjia që ke në dorë.
- 18. Carson i fumetti-t.
- 19. U shkrua nga Sartre.
- 20. Në fund të vitit.
- 22. Është lloj poezie.
- 24. Janë shtëpi... qeni.
- 25. Janë kapriçiot.
- 27. Verifikuar pjesërisht.
- 28. Kërcimi i Fred Astaire.
- 31. Është sekrete në derë.
- 34. Kodi i celularit.
- 36. Daja i Amerikës.
- 39. Kaluar në krye.
- 43. Fillojnë detyrën.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Atkinson, alias Mister Bean.
- 5. Ishte dyqanxhi i dikurshëm.
- 10. Ferrara regjisor.
- 12. Kalohet në gjumë.
- 14. Të parat në sondazh.
- 15. Është nofka.
- 16. Një treshe në skenë.
- 19. Nuk i tregohen babait.
- 21. Gjysmë tatimi.
- 23. Berenger aktor.
- 24. Në mes të një forme.
- 25. Bëjnë stil të lirë
- 28. Fillojnë nazet
- 29. Kalimi në kufij.
- 30. Një tragjedi... e Dreiser.
- 33. Grier aktore.
- 34. Dashi kur mungon ai
- 36. Është zanore në filma
- 38. Kufizohet në kufij
- 39. Entë Civile Europiane.

VERTIKAL


- 40. Janë galeri në hekurudhë.
- 41. Ramazzotti këngëtar
- 42. Mbyllin një tender.
- 43. Agjenci Formacioni Tiranë.
- 44. Është pjesë e borxhit që paguhet.
- 46. Gjysmë tatimi
- 48. Jessica Parker aktore.
- 49. Inicialet e Presley.
- 50. Nuk shuhej dot ngas Tantalit.
- 51. Janë brinjët në skuadër.
- 52. Qendër fitimi
- 8. Mbyllin portat.
- 9. Pak latinisht.
- 11. Janë zjarrvënë.
- 13. Qyteti i perjeshtëm.
- 17. Kufizojnë rastet.
- 18. Shkroi Këngëtarja tullce.
- 20. Inicialet e Moravia-s.
- 22. Janë trille.
- 25. Qytet italian.
- 26. Jepen për hartim.
- 27. Fillojë takimet.
- 29. Kufizojnë kënde.
- 31. Janë vendet e para.
- 32. Një greminë
- 35. Është logorin që qërohet.
- 36. Ndëqen me ilaçe.
- 37. Massari aktore italiane.
- 38. Janë kapot.
- 40. Numri i oktetit.
- 41. Kush ka... fërgëllon.
- 44. Një i fundit mbi të gjithë.
- 45. Një pjesë e satelitetëve.
- 47. Fillojnë tjetrën.
- 48. Derisa janë në fund.
- 49. Inicialet e Taylor aktore.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIË TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

M A T A H E L M E T
 A R R V E D E P M E T
 P A R A L E L E T L E R
 P O L I F E M I O L E
 E M I L E Z O L A E T I K
 L A I R A E R R E Z E
 E R A T B E M R I I S
 H T M A E S T R O D E
 T A L E N T E T A R E A
 E S I P R I T A T R
 K A P A N O N E T L A L A

FJALËKRYQI (2)

D I S K O F E K A T A P
 R O M A N A R G O S A
 E N T G N I R H R
 W M O N O G R A F I A A
 P E L E G R I N A Z H E T
 P O L I G L O T E T I D E
 A L E K K A H E T K S H
 K E N T I T K A T E T
 E M I L E E N J O M E R I
 T I M E R S T A N E T I
 A K S E R I O Z R A M
 T E O T R A Z J A R R I

SUDOK

5			6			9	8	7
	2							4
	9	1		3				6
	5	2		6				7
1	6	9				7	5	
3		7	9				8	
			7	1	5	6		
	1			2		6		3
						8		4

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	3	4	5	8	1	6	9	2
9	5	1	2	6	4	3	7	8
2	6	8	7	9	3	5	1	4
8	9	6	3	1	7	4	2	5
4	1	2	6	5	8	7	3	9
3	7	5	4	2	9	1	8	6
6	2	9	1	3	5	8	4	7
1	8	7	9	4	6	2	5	3
5	4	3	8	7	2	9	6	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Burgu më i madh në të cilin njerëzit jetojnë është frika se çfarë mendojnë të tjerët!!!

- Nëse rrudhat duhet të "shkruhen" mbi ballin tonë, nuk duhet të "shkruhen" dhe në zemër. Shpirti nuk duhet të plakët.

- Pengesa më e madhe është frika ... ndjenja më e keqe është zemërimi... dhe gabimi më i madh është braktisja!!!

- Askush nuk është aq i pasur që të mos ketë nevojë për një buzëqeshje. Dhe askush nuk është aq i varfër që të mos mund ta jap!

Thënie të mënçura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	H	2	I	16	J	A		12	7		7	8	6	11	S	T	R	I	P	B	B	V	O	T	A		
1	4	3	8			10	1	14		5			1	8	S	H	E	R	O	I	N	A		O	V	E	R
18	1	8		5	3	9	3	8	2	12	2				S	A	S	S	N	R	V		R	T			
2	8		5	6	4	6	9	1	9	2			8		U	T	S	H	T	E	T	E	R	O	R	E	
6		12	1	15	2	8	1	11	2	7	8	3			B	L	I	T	E	R	A	T	U	R	A	T	
6	1	11		12	9	1			8		9	11			M	I	N	E	R	A	L	E	T	C			
9	3	1		2	6		7	16	2		1	3			K	A	L	O	R	E	S	I	T	H	A	V	
3		7		4		1	8	6		8	2	14			C	A	R	I	S	T	I	N	T	L			
	15	2	7	7			15	6	3	11		4	6		V	H	I	M	I	M	I	K	E				
4	2	12	2		8				11		1	15	3	17	R	A	M	E	T	N	A	A	R	R			
1	4	3	7	8	3	20	2	7	6		8	1			A	D	R	E	S	E	I	T	A	L	I	A	
8	1			18	1	9	1	12	1		2	8			P	O	L	E	M	I	K	A	S	E	A	T	

- Është e dhimbshme për ti thënë "lamtumirë" një personi që nuk do të të braktiste kurrë ... por më e dhimbshme është ti kërkosh një personi të qëndrojë duke e ditur se një ditë do të të braktisë!!!
- Kur bëni një zgjedhje, mos mendoni nëse kjo është e drejtë apo e gabuar ... Mendo të jetë vetëm ajo që me të vërtetë ti dëshiron!!!

- Duhet një minutë për të parë një person të veçantë, një orë për ta vlerësuar, një ditë për ta dashur-uar, një jhalë për ta lënduar ... dhe një jetë për ta haruar atë!!!
- Heshnja është si ngjyra e ujit që nuk e shihni, por është i nevojshëm!!!

